



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 96

Tiranë – E enjte, 28 maj 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 52/2020 datë 30.4.2020	Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar..... 5593
Dekret i Presidentit nr. 11488, datë 26.5.2020	Për shpallje ligji..... 5607
Ligj nr. 53/2020 datë 30.4.2020	Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar..... 5607
Dekret i Presidentit nr. 11489, datë 26.5.2020	Për shpallje ligji..... 5608
Ligj nr. 57/2020 datë 30.4.2020	Për pyjet..... 5608
Dekret i Presidentit nr. 11490, datë 26.5.2020	Për shpallje ligji..... 5636



LIGJ
Nr. 52/2020

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN
NR. 10 448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E
MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

1. Në nenin 3, pika 13, pas shprehjes “Leja e mjedisit e tipit B, është leja” shtohet shprehja “për veprimtaritë e përcaktuara në aneksin 1/B”.

2. Pika 14, e nenit 3, kreu IV, neni 21, pika 2, e nenit 24 dhe neni 31, shfuqizohen.

Neni 2

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë:

“1. Në përputhje me ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, krijohet një sistem prej dy nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipave A e B, si më poshtë:”.

2. Në pikën 1, shkronja “c” shfuqizohet.

3. Në pikën 2, shkronja “ç” shfuqizohet.

4. Pika 3 riformulohet, si më poshtë:

“3. Lista e veprimtarive të përfshira dhe kushtet e lejes së mjedisit të tipave A dhe B rishikohen në çdo kohë nga ministria kur ka ndryshime në legjislacionin përkatës mjedisor, të cilit ato i përmbahen dhe në raste kur konstatohen nga autoritetet kompetente, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, nëse:

a) evidentohet ekzistenca e veprimtarive të reja që kanë ndikim në mjedis;

b) shfaqen elemente të reja ekologjike, të panjohura në kohën e dhënies së saj;

c) dalin dispozita të reja për mjedisin, që e kërkojnë shprehimisht ndryshimin e saj;

ç) vërtetohet ndotje tej normave të lejuara;

d) ka ndryshime themelore të veprimtarisë;

dh) ka përparime në fushën e teknikave më të mira të mundshme, që lejojnë pakësimin e rëndësishëm të shkarkimeve në mjedis dhe që nuk kërkojnë shpenzime të mëdha.”.

Neni 3

Kudo në nenin 19, fjalët “dhe Inspektoratin Shtetëror Kompetent” hiqen.

Neni 4

Në nenin 23 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 shfuqizohet.

2. Në pikat 3 dhe 4, fjalët “në pikat 1 dhe 2, të këtij neni” dhe “sipas përcaktimit në pikat 1 dhe 2, të këtij neni” zëvendësohen me fjalët “në pikën 1, të këtij neni”.

Neni 5

Në nenin 25 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë:

“3. Operatori i instalimit i paguan çdo vit një tarifë vjetore ministrisë për instalimet e tipave A dhe B, përkatësisht”.

2. Pika 6 shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 26, fjalët: “agjencia përkatëse rajonale e mjedisit” dhe “ARM-ja” hiqen.

Neni 7

Në nenin 27 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli ndryshohet si më poshtë:

“Shfuqizimi i lejeve të mjedisit të tipave A dhe B”.

2. Fjalja hyrëse ndryshohet, si më poshtë:

“Ministri, për lejet e mjedisit të tipave A dhe B, mund të pezullojë ose të shfuqizojë lejen e mjedisit kur:”.



Neni 8

Në nenin 29 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, paragrafët “iii”, të shkronjave “a” dhe “b”, shfuqizohen.

2. Në pikën 2, fjalët: “agjencia përkatëse rajonale e mjedisit” hiqen.

3. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë:

“8. Ministri, me propozimin e strukturës përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit, në rastet kur gjoba nuk është paguar brenda afatit të përcaktuar, vendos pezullimin e lejes përkatëse të mjedisit për të gjithë veprimtarinë ose pjesë të saj deri në pagesën e gjobës. Vendimi i pezullimit publikohet menjëherë në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe i dërgohet zyrtarisht QKB-së.”.

Neni 9

1. Shtojca 1, e ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Kudo në tekstin e ligjit:

a) fjalët: “A, B dhe C” zëvendësohen me fjalët: “A dhe B”;

b) fjalët: “Qendra Kombëtare e Licencimeve” dhe “QKL” zëvendësohen me fjalët: “Qendra Kombëtare e Biznesit” dhe “QKB”;

c) fjalët: “dhe inspektoratin shtetëror kompetent” zëvendësohen me fjalët: “dhe strukturën përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit”;

ç) fjala: “revokim” zëvendësohet me fjalën: “shfuqizim”.

Neni 10

Dispozita kalimtare

1. Të gjitha instalimet ekzistuese të tipit C, të cilat, në varësi të kapacitetit referuar shtojcës 1, të

këtij ligji, klasifikohen si leje mjedisit të tipit B, aplikojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për t’u pajisur me leje mjedisi të tipit B brenda 12 muajve, nga hyrja në fuqi e ligjit.

2. Të gjitha instalimet e cituara në pikën 1, të këtij neni, vazhdojnë të dorëzojnë raportin për zbatimin e kushteve të lejes së mjedisit të tipit C pranë agjencisë rajonale të mjedisit përkatës, deri në momentin që do të aplikojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për t’u pajisur me leje mjedisi të tipit B.

3. Të gjitha instalimet ekzistuese të tipit C, të cilat nuk klasifikohen si leje mjedisi të tipit B, sipas pikës 1, të këtij neni, me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen.

4. Kërkesat e posaçme për shqyrtimin e aplikimeve për leje mjedisi të tipit B, për instalimet e cituara në pikën 1, të këtij neni, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente, të përcaktuara në këtë ligj, deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja, do të miratohen me urdhër të ministrit, brenda 1 muaji, nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 11

Shfuqizime

Pas hyrjes në fuqi të ligjit, çdo parashikim për lejet e mjedisit të tipit C, në ligjin nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që vjen në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 30.4.2020

Shpallur me dekretin nr. 11488, datë 26.5.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta



Shtojca 1

Lejet e mjedisit të tipave A dhe B, në varësi të kapacitetit prodhues kufi

Kur një operator kryen veprimtari të ndryshme nën të njëjtin nëntitull, si më poshtë, dhe në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive mbledhen bashkë. N.q.s. nuk përcaktohet ndryshe, në tabelën e mëposhtme, kapaciteti **kufi** nënkupton kapacitetin e plotë prodhues të asaj veprimtarie, pavarësisht nga fakti nëse ai shfrytëzohet plotësisht apo jo.

	ID	Veprimtaria	Kapaciteti kufi për lejet e tipit A	Kapaciteti kufi për lejet e tipit B
Industritë energjetike	1.1	Instalimet me djegie.	Energjia termike në hyrje është e barabartë ose më e madhe se 50 MW.	Inputi (energji) termike është më e vogël se 50 MW.
	1.2	Rafineritë e hidrokarbureve, naftës dhe nënprodukteve të saj dhe gazit.	Të gjitha instalimet.	
	1.3	Furrat e koksit.	Të gjitha instalimet.	
	1.4	Instalimet e gazifikimit dhe lëngëzimit të qymyrit.	Të gjitha instalimet.	
	1.5	Kërkimi i naftës dhe i gazit natyror .	Të gjitha instalimet.	
	1.6	Nxjerrja e naftës dhe e gazit natyror.	Të gjitha instalimet.	
	1.7	Gaz natyror aromatik ose GNL, përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A, ose përzierje e aromave.		Të gjitha instalimet.
	1.8	Përzierje aromash për t'u përdorur me gazin natyror ose naftën e lëngështuar.		Të gjitha instalimet.
	1.9	Shpërndarja dhe magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj: a. magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisterna të palëvizshme në ndonjë terminal , ose ngarkim /shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në /nga një cisternë e lëvizshme, cisternë hekurudhore, ose anije e ujërave të brendshme në terminal; b. shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisternat e stacioneve të furnizimit me karburant.		Të gjitha instalimet.
	1.10	Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane.		Të gjitha instalimet.
Prodhimi dhe përpunimi i metaleve	2.1	Pjekja ose aglomerimi i xeherorëve metalikë (përfshirë xeherorët sulfur).	Të gjitha instalimet.	



	2.2	Prodhim i gizës ose çelikut (shkrirje primare dhe sekondare) duke përfshirë derdhjen e vazhdueshme.	Kapaciteti prodhues është më i madh se 2,5 ton/orë.	Kapaciteti prodhues është i barabartë me 2,5 ton/orë ose më i vogël se kaq.
	2.3	a. Përpunim i metaleve ferrose – me mullinj me rula në të nxehtë.	Kapaciteti prodhues është më i madh se 20 ton çelik bruto në orë.	Kapaciteti prodhues është i barabartë me 20 ton çelik bruto në orë ose më i vogël se kaq.
		b. Përpunim i metaleve ferrose - me farkëtim.	Energjia është më e madhe se 50 kilojoule për goditës, dhe fuqia kalorifike është më e madhe se 20 MW.	Energjia është e barabartë me 50 kilojoule për goditës ose më pak se kaq, dhe fuqia kalorifike është e barabartë me 20 MW, ose më pak se kaq.
		c. Përpunim i metaleve ferrose - dhe aplikimi i veshjes me metal të shkrirë.	Furnizimi i procesit me materiale është më i madh se 2 ton/orë çelik bruto.	Hyrja është e barabartë me 2 ton/orë çelik bruto ose më pak se kaq.
	2.4	Fonderitë e metaleve ferrose.	Kapaciteti prodhues është më i madh se 20 ton/ditë.	Kapaciteti prodhues është i barabartë me 20 ton/ditë ose më pak se kaq.
	2.5	a. Prodhim bruto i metaleve me ngjyrë nga xeherorët, nga koncentratet ose lëndë të para dytësore nga procese metalurgjike, kimike ose elektrolitike.	Të gjitha instalimet.	
		b. Shkrirja dhe përftimi i aliazheve të metaleve jo-ferrose (me ngjyrë) përfshirë produktet e rikuperuar (duke përfshire rafinimin dhe derdhjen në fonderi).	Kapaciteti shkrirës është më i madh se 4 ton/ditë për plumbin ose kadmiumin, ose më i madh se 20 ton/ditë për të gjitha metalet e tjera.	Kapaciteti shkrirës është i barabartë me 4 ton/ditë për plumbin ose kadmiumin ose më pak se kaq, ose 20 ton/ditë për të gjitha metalet e tjera.
	2.6	Trajtime sipërfaqësore të metaleve dhe plastikave duke përdorur procese elektrolitike ose kimike.	Volumi i depozitës së trajtimit më i madh se 30 m ³ .	Volumi i depozitës së trajtimit është i barabartë me 30 m ³ ose më pak se kaq.
Industria minerare	3.1	a. Prodhimi i klinkerit të çimentos në furra rrotulluese.	Kapaciteti prodhues është më i madh se 500 ton/ditë.	Kapaciteti prodhues është i barabartë me 500 ton/ditë ose më pak se kaq.
		b. Prodhim i gëlqeres në furra rrotulluese.	Kapaciteti prodhues është më i madh se 50 ton/ditë.	Kapaciteti prodhues është i barabartë me 50 ton/ditë, ose më pak se kaq.
		c. Prodhim i klinkerit të çimentos ose gëlqeres në furra të tjera.	Kapaciteti prodhues është më i madh se 50 ton/ditë.	Kapaciteti prodhues është i barabartë me 50 ton/ditë ose më pak se kaq.
		d. Magazini, ngarkimi ose shkarkimi në masë të madhe i çimentos ose i klinkerit të çimentos përpara transportimit të tyre në masë të madhe.		Kapaciteti i barabartë me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.
		e. Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të		Të gjitha instalimet.



		betonit dhe produkteve të tjera të çimentos, si dhe prodhimi i llaçit, kollës, gëlqeres (parafabrikeve, paletave, etj.).		
3.2	a.	Prodhim i asbestit ose i produkteve me bazë asbesti.	Të gjitha instalimet.	
	b.	Prodhim i produkteve me bazë asbesti.	Të gjitha instalimet.	
	c.	Nxjerrje e asbestit nga mjetet e transportit hekurudhor, me përjashtim të rasteve: i) gjatë riparimit ose mirëmbajtjes së makinerisë; ii) gjatë operacioneve të rikuperimit pas një aksidenti, ose iii) në rastet kur asbesti është mbuluar përgjithnjë me çimento ose ndonjë material tjetër (përfshirë plastikën, gomën ose rrëshirën).		Të gjitha instalimet.
	d.	Shkatërrimi i mjeteve të transportit hekurudhor përmes djegies kur asbesti është i inkorporuar ose është shpërndarë në gjithë strukturën e tij.		Të gjitha instalimet.
	e.	Lustrimi industrial duke përfshirë gdhendjen, shpimin ose montimin e produkteve të prodhuara prej asbesti, ose ndonjërit nga produktet e mëposhtme që nuk janë të lidhura me prodhimin – i) filtrat prej asbesti ii) produktet e fërkimit prej asbesti iii) lidhjet, paketimet dhe materialet e përforcimit prej asbesti; iv) paketimet prej asbesti; v) tekstilet prej asbesti.		Të gjitha instalimet.
3.3		Prodhimi i qelqit dhe fibrave të qelqit.	Kapaciteti shkrirës është më i madh se 20 ton/ditë.	Kapaciteti shkrirës është i barabartë me 20 ton/ditë ose më pak se kaq.
3.4	a.	Shkrirje e substancave minerare.	Kapaciteti shkrirës është më i madh se 20 ton/ditë.	Kapaciteti shkrirës është i barabartë me 20 ton/ditë ose më pak se kaq.
	b.	Prodhimi i substancave minerare.	Kapaciteti shkrirës është më i madh se 20 ton/ditë.	Kapaciteti shkrirës është i barabartë me 20 ton/ditë ose më pak se kaq.
3.5	a.	Prodhim i produkteve qeramike nëpërmjet pjekjes, përfshirë tjegullat, tullat, tullat refraktare, pllakat,	Kapaciteti prodhues është më i madh se 75 ton/ditë, dhe/ose kapaciteti i furrës, është më i madh se 4 m ³ dhe me densitet	Kapaciteti prodhues është i barabartë me 75 ton/ditë, ose më pak se kaq, dhe/ose kapaciteti i furrës është i



		prodhimet e poçerisë/qeramikës apo të porcelanit.	vendosje që është më i madh se 300 kg/m ³ për çdo furrë.	barabartë me 4 m ³ ose më pak se kaq dhe me densitet vendosje për çdo furrë që është i barabartë me 300 kg/m ³ , ose më pak se kaq.
		b. Pjekje e produkteve prej argjile të rëndë ose produkte zjarrduruese, përveçse produkteve prej argjile të rëndë në një furrë ku veprimtaria nuk përfshihet në përshkrimin e kategorisë 3,5 a më lart.		Të gjitha instalimet.
		c. Lustrim me avull të produkteve prej balte (poçeri/qeramikë), ose prej argjile me kripëra.		Të gjitha instalimet.
	3.6	Minierat nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to.		Të gjitha instalimet.
	3.7	Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret .		Të gjitha instalimet.
	3.8	Gërmimet nën ujërat bregdetare ose ujërat sipërfaqësore kontinentale.		Të gjitha instalimet.
	3.9	Përpunimi, prerja dhe lustrimi i mermerit dhe gurëve dekorativ.		Kapaciteti përpunues është i barabartë me 5 m ³ /ditë ose më i madh se kaq.
	3.10	Prodhimi i produkteve abrazive.		Të gjitha instalimet
	3.11	Prodhimi dhe fraksionimi i produkteve minerale jometalike.		Të gjitha instalimet.
	3.12	Impiantet e pasurimit të mineraleve.		Të gjitha instalimet.
Industria kimike (1)	4.1	Prodhimi i kimikateve organike bazë (2).	Të gjitha instalimet.	
	4.2	Prodhimi i kimikateve inorganike bazë (3).	Të gjitha instalimet.	
	4.3	Prodhim i plehëruesve me bazë fosfori-azoti ose potasiumi (plehërues të thjeshtë apo të përzier).	Të gjitha instalimet.	
	4.4	Prodhim i produkteve bazë për shëndetin e bimëve dhe të biocideve.	Të gjitha instalimet.	
	4.5	a. Prodhim i produkteve farmaceutike bazë me anë të proceseve kimike ose biologjike.	Të gjitha instalimet.	
		b. Përpunimi/ përzierja e produkteve farmaceutike bazë.		Të gjitha instalimet.
	4.6	Prodhim i eksplozivëve.	Të gjitha instalimet.	
	4.7	Magazinimi i kimikateve, përveçse kur paraqiten si pjesë e ndonjë veprimtarie		I barabartë ose më i madh se limitet e mëposhtme: Secili ose disa prej akriloidëve



		tjetër të tipit A ose tipit B, dhe përveç ndodhjes në një cisternë të lëvizshme.		20 tonë; Akrilonitrilet 20 tonë; Amoniak anhidrid prej 100 tonë; Fluorur hidrogjeni anhidrid 1 tonë; Toluen di-isocianati 20 tonë; Monomer klorid vinyl 20 tonë; Etilene 8000 tonë.
	4.8	Prodhiimi dhe përpunimi /përzjerja e produkteve kozmetike.		Të gjitha instalimet.
	4.9	Prodhiimi dhe përpunimi /përzjerja e produkteve të pastrimit /detergjenteve.		Të gjitha instalimet.
Menaxhimi i mbetjeve	5.1	a. Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi.	Të gjitha instalimet.	
		b. Incinerimi i mbetjeve urbane jo të rrezikshme.	Të gjitha instalimet.	
		c. Incinerim i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafshëve në një instalim incinerimi, përveç atij të referuar në pikën 5.1 a	Instalimi i incinerimit përdoret ose është dizenuar për të djegur mbetje me intensitet më shumë se 1 ton/orë.	Instalimi i incinerimit përdoret ose është dizenuar për të djegur mbetje me intensitet të barabartë me 1 ton/orë ose më pak se kaq.
	5.2	a. Lendfilli i mbetjeve (D1) duke përjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte.	Kapaciteti i depozitimit është më i madh se 10 ton/ditë ose kapaciteti i dizenuar i lendfillit është më i madh se 25000 tonë.	Kapaciteti depozitues është i barabartë me 10 ton/ditë ose më pak se kaq ose kapaciteti i dizenuar i lendfillit është 25000 tonë ose më pak se kaq.
		b. Lendfill i mbetjeve inerte.		Të gjitha instalimet.
	5.3	a. Asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme përveç incinerimit (5.1.a) ose lendfillimit (5.2 a).	Kapaciteti i përpunimit është më i madh se 10 ton/ditë.	Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 10 ton/ditë ose më pak se kaq.
		b. Asgjësimi i vajrave të përdorur përveç incinerimit (5.1 a) ose lendfillimit (5.2.a).	Kapaciteti i përpunimit është më i madh se 10 ton/ditë.	Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 10 ton/ditë, ose më pak se kaq.
		c. Asgjësim i mbetjeve jo të rrezikshme me trajtim biologjik (D8).	Kapaciteti përpunimit është më i madh se 10 ton/ditë.	Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 50 ton/ditë ose më pak se kaq.
		d. Asgjësim i mbetjeve jo të rrezikshme me trajtim fiziko – kimik (D9).	Kapaciteti i përpunimit është më i madh se 50 ton/ditë.	Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 50 ton/ditë ose më pak se kaq.
		e. Asgjësimi i mbetjeve jo të rrezikshme me metoda të tjera përveç (D1), (D8) ose (D9).		Të gjitha instalimet.
	5.4	a. Rikuperim i mbetjeve të rrezikshme me anë të operacioneve R1, R5, R6, R8, ose R9.	Të gjitha instalimet.	



		b. Rikuperim i mbetjeve të rrezikshme me anë të operacioneve R2, R3, R4, R7 ose R10.		Të gjitha instalimet.
		c. Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme		Të gjitha instalimet.
	5.5	Magazinin i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme.		Kapaciteti i barabarte me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.
	5.6	a. Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/ paketimeve ose kontejnerëve në mënyrë që të ripërdoren.		Kapaciteti i barabarte me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.
		b. Magazinin i mbetjeve në lidhje me zbatimin e veprimtarive të pikës 5.6 a.		Kapaciteti i barabartë me 50 ton/dite ose më i madh se kaq.
	5.7	Magazinin, trajtim, riparim ose rinovim i mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike (WEEE).		Të gjitha instalimet.
	5.8	Magazinin, rikuperim i hekurishteve/ skrapeve të metalit ose çmontim i mbetjeve nga motorët e makinave.		Të gjitha instalimet.
	5.9	Magazinin i përkohshëm i mbetjeve duke përfshirë tepricat e produkteve nga kontejnerët ose nga larjet e kontejnerëve, dhe çdo mbetje të rrezikshme në mjediset pritëse të një zone portuale dhe ku mbetjet janë magazinuar për jo më shumë se 7 ditë.		Të gjitha instalimet.
	5.10	a. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart.		Të gjitha instalimet.
		b. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart.		Kapaciteti i barabartë me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.
	5.11	Kompostim i mbetjeve bio.		Kapaciteti i kompostimit më i madh se 50 ton/ditë.
Trajtimi i ujërave dhe ujërave të zeza	6.1	Instalim trajtimi për ujërat e ndotura urbane.		Të gjitha instalimet.
	6.2	Trajtimi i ujërave të ndotura industriale në vendin ku krijohen.		Të gjitha instalimet.
	6.3	Përdorimi i llumit të ujërave të zeza në tokë.		Të gjitha instalimet.
	6.4	Magazinin dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane duke përfshirë: - llumin nga ujërat e ndotura urbane; - llumin e cisternave septike;		Kapaciteti i trajtimit i barabartë ose më i madh se 30 m ³ /ditë. Kapaciteti magazinues i barabartë ose më i madh se 50 m ³ vëllim depozitues.



		- mbetjet e ujërave të zeza nga gropa të hapura; - mbetjet nga pastrimi i kanaleve të ujërave të zeza.		
Veprimtaritë e prodhimit të letrës, pulpës dhe dërrasës	7.1	a. Prodhim i pulpës nga trungjet e drurit dhe materiale të tjera fibroze.	Të gjitha instalimet.	
		b. Prodhim i letrës dhe/ose i kartonit.	Kapaciteti prodhues është më i madh se 20 ton/ditë.	Kapaciteti prodhues është i barabartë me 20 ton/ditë ose më pak se kaq.
		c. Prodhim i dërrasës me ristela dhe me fibra, kompresat ose me çdo përbërje tjetër me bazë druri.		Të gjitha veprimtaritë.
Veprimtaritë e karbonit	7.2	Prodhim i karbonit ose qymyrit që digjet me vështirësi me anë të djegies ose grafitizimit.	Të gjitha instalimet.	
Veprimtaritë e katranit dhe të bitumit	7.3	a. Distilim i katranit ose i bitumit në lidhje me ndonjë proces prodhimi.		Të gjitha instalimet.
		b. Ngrohjen e katranit për prodhimin e elektrodave ose materialeve refraktare me bazë karboni.		Të gjitha instalimet.
		c. Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3.a ose 7.3.b, ose në pika të tjera të kësaj Shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi.		Të gjitha instalimet.
		d. Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3.a ose 7.3.b ose në pika të tjera të kësaj Shtojce, që përfshijnë oksidimin e bitumit duke fryrë ajër përmes saj, në fabrikën ku nuk kryhet asnjë nga aktivitetet e përshkruara në ndonjë seksion të kësaj shtojce.		Të gjitha instalimet.
Përpunimi i tekstileve ose fibrave	7.4	Fabrika për trajtimin paraprak ose ngjyrosjen e tekstileve dhe fibrave (veprime të tilla si: larje, zbardhje, mercerizim).	Kapaciteti përpunues është më i madh se 10 ton/ditë.	Kapaciteti përpunues është i barabartë me 10 ton/ditë ose më pak se kaq.
Përpunimi i gëzofit	7.5	Instalime për krehjen dhe lyerjen e gëzofëve.		Kapaciteti përpunues është më i madh se 10 ton/ditë.
Trajtimet me regjie dhe prodhimi i lëkurës	7.6	a. Regjia e lëkurëve të papunuara dhe shollave.	Kapaciteti trajtues është më i madh se 12 ton/ditë produkt të përfunduar.	Kapaciteti përpunues është i barabartë me 12 ton/ditë produkt të përfunduar ose më pak se kaq.



		b. Prodhime të produkteve të lëkurës përveç rastit kur është pjesë e një veprimtarie tjetër në këtë shtojcë.		Të gjitha instalimet.
Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to	7.7	a. Thertore.	Kapaciteti prodhues i karkasave është më i madh se 50 ton/ditë.	Kapaciteti prodhues i karkasave është i barabartë me 50 ton/ditë ose më pak se kaq, por gjithsesi më shumë se 2 ton/ditë
		b. Asgjësim ose riciklim i karkasave të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve, me mënyra të tjera përveç shndërrimit ose incinerimit, të përmendura në ndonjë veprimtari tjetër të kësaj shtojcë.	Kapaciteti i trajtimit është më i madh se 10 ton/ditë të karkasave të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve ose të dyja bashkë.	Kapaciteti i trajtimit është i barabartë me 10 ton/ditë ose më pak se kaq karkasa të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve ose të dyja bashkë.
		c. Trajtimi dhe përpunimi i materialeve të nevojshme për prodhimin e ushqimeve nga lëndët e para nga kafshët (përveç qumështit).	Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është më i madh se 75 tonë në ditë.	Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është i barabartë me 75 tonë në ditë ose më pak se kaq, por më shumë se 5 ton/ditë.
		d. Trajtimi dhe përpunimi i materialeve të nevojshme për prodhimin e produkteve ushqimore nga lëndët e para vegjetale.	Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është më i madh se 300 tonë në ditë (vlerë mesatare duke u bazuar në të dhëna trimestrale).	Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është i barabartë me 300 tonë në ditë ose më pak se kaq (vlerë mesatare bazuar në të dhënat trimestrale), por më shumë se 10 ton/ditë.
		e. Trajtimi dhe përpunimi i qumështit.	Sasia e qumështit në hyrje është më e madhe se 200 ton/ditë (vlerë mesatare bazuar në të dhëna vjetore).	Sasia e qumështit në hyrje është e barabartë me 200 tonë në ditë ose më pak se kaq (vlerë mesatare bazuar në të dhënat vjetore), por më shumë se 2 ton/ditë.
		f. Trajtim ose magazinim i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve.		Të gjitha instalimet.
		g. Prodhim dhe ambalazhim i pijeve joalkoolike (përveç ujit).		Të gjitha instalimet.
		h. Prodhim i alkoolit dhe pijeve alkoolike.		Kapaciteti prodhues mbi 20000 l/vit.
		i. Prodhimi i birrës.		Të gjitha instalimet.
		j. Prodhim i produkteve të frutave.		Të gjitha instalimet.
		k. Prodhim i xhelatinës dhe i materialeve ngjitëse nga lëkurat dhe kockat.		Të gjitha instalimet
		l. Prodhimi i produkteve të duhanit.		Kapaciteti prodhues mbi 2 ton/vit
		m. Prodhim i ushqimit për kafshë.		Të gjitha instalimet.
Blegtoria	7.8	a. Rritje intensive e shpendëve në një instalim.	Me kapacitet më shumë se 40000 (krerë) vende shpendësh.	Me kapacitet 40000–1000 (krerë) vende shpendësh.
		b. Rritje intensive e derrave në një instalim.	Me kapacitet më shumë se 2000 (kokë) vende për derra me peshë mbi 30 kg.	Me kapacitet 2000–200 (kokë) vende për derra me peshë mbi 30 kg.



		c. Rritje intensive e derrave në një instalim.	Me kapacitet më shumë se 750 (kokë) vende për dosa.	Me kapacitet 750–100 (kokë) vende për dosa.
		d. Rritje intensive e gjedhit në një instalim.		Me kapacitet më shumë se 50 (njësi) vende gjedhi.
		e. Rritje intensive e kafshëve të tjera të cilat nuk janë përmendur më lart.		Bazuar në mënyrën e konvertimit të kafshëve të tjera në njësi gjedhi (me rregullore të Ministrat të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave).
Veprimtaritë e mbulimit të sipërfaqes dhe të stampimit	7.9	a. Instalimet për trajtimin e sipërfaqes së substancave, objekteve ose produkteve duke përdorur tretës organikë, në mënyrë të veçantë për t'i krehur, stampuar, veshur me cipë, zhvajosur, mbrojtur nga uji, kalibruar, lyer, pastruar ose regjur /ngopur/lagur në thellësi.	Kapaciteti konsumues është më shumë se 150 kg/orë ose më shumë se 200 ton/vit.	Kapaciteti konsumues është 150 kg/orë, ose më pak, ose 200 ton/vit, ose më pak se kaq.
		b. Aplikimi ose heqja e materialeve veshëse që përmbajnë ndonjë përbërës tributyltin ose triphenyltin, n.q.s. ndodhet në kantier detar.		Kantier detar ku anijet me një gjatësi prej 25 m ose më shumë mund të ndërtohen, mirëmbahen ose riparohen.
		c. Riparim ose ri-sprucim i avionëve ose mjeteve të transportit hekurudhor ose pjesëve të tyre.		Të gjitha instalimet.
		d. Ri-ngjyrosje ose risprucim i mjeteve të transportit rrugor ose pjesëve të tyre.		Ka gjasë që në çdo periudhë 12-mujore veprimtaria të përdorë 1 ton solvente organike.
		e. Përveç rasteve të përmendura në 7.9.c dhe 7.9.d, çdo proces (duke përfshirë ri-ngjyrosjen ose ri-sprucimin plotësisht ose pjesërisht të avionëve, mjeteve të transportit hekurudhor ose rrugor) për aplikime mbi nënshtresat ose që bën tharjen, ose kujdeset pas këtyre aplikimeve, stampon me bojë ose ngjyros ose aplikon çdo material tjetër veshës si një veprimtari prodhimi ose gjatë veprimtarisë së prodhimit.		Ka gjasë që në çdo periudhë 12-mujore veprimtaria të përdorë: i. 20 tonë ose më shumë bojë stampimi, ngjyrosje ose material tjetër veshës që aplikohet në trajtë të ngurtë; ii. 20 tonë ose më shumë për çdo veshje metali që sprucohet në trajtë të shkrirë; iii. 25 tonë ose më shumë solucione organike për çdo lloj aktiviteti ofset në të ftohtë, ose veprimtari printimi ofset me fletë; ose iv. 5 tonë ose më shumë për çdo veprimtari që nuk është përmendur në nënparagrafin (iii).
		f. Përveç rasteve të përmendura në tipin A të kësaj shtojce, prodhimi ose formulimi i bojës së stampimit ose të çdo materiali tjetër veshës që përmban ose përfshin		Të gjitha instalimet.



		përdorimin e solucioneve organike.		
		g. Përveç rasteve të përmendura në tipin A të kësaj shtojce, prodhimi i pluhurit si material veshës.		Të gjitha instalimet.
Veprimtaritë e lëndës së drurit	7.10	a. Kujdesja ose tretja kimike e lëndëve të drurit, si pjesë e procesit të prodhimit, ose prodhime të përbëra tërësisht ose kryesisht nga druri.		Të gjitha instalimet.
		b. Përveç rasteve të përmendura në kategori të tjera të kësaj Shtojce, prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri n.q.s. veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit.		Ka gjasë që në çdo periudhë 12-mujore rezultati i veprimtarisë të jetë: i. 10 000 m ³ kur druri vetëm sharrohet; ii. 1 000 m ³ në çdo rast tjetër.
Veprimtaritë e gomës	7.11	a. Prodhimi i gomave të reja për makinat (por duke mos përfshirë riderdhjen dhe riveshjen).		Të gjitha instalimet.
		b. Përveç rasteve të përmendura në ndonjë nga veprimtaritë e tipit A, në këtë shtojcë, trazimi, bluarja ose përzierja e: i. gomës natyrale; ose ii. elastomereve me përbërje sintetike organike, n.q.s. është përdorur karboni i zi.		Të gjitha instalimet.
		c. Riderdhja dhe riveshja e gomave.		Të gjitha instalimet.
Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve	7.12	a. Procesi i tharjes së shpejtë të bojës së stampimit/printimit me anë të ajrit të nxehtë.		Konsumi i solventëve është më i madh se 15 ton/vit.
		b. Publikim i materialeve me atë të procesit rotogravurë.		Konsumimi i solventëve është më i madh se 25 ton/vit.
		c. Procese të tjera rotogravurë, flexografi, stampim/printim me makinë shtypi rotativë, laminim ose lustrim.		Konsumimi i solventëve është më i madh se 15 ton/vit.
		d. Stampim/printim me makinë shtypi rotativë mbi tekstile/karton.		Të gjitha instalimet.
		e. Pastrim i sipërfaqes duke përdorur substanca ose preparate që për shkak të përbërjes së tyre të avullueshme, klasifikohen si		Të gjitha instalimet.



		kancerogjene, mutagjeneve ose toksike për riprodhimin.		
		f. Pastrues të tjerë sipërfaqesh.		Të gjitha instalimet.
		g. Lyerja dhe lustrimi i makinave.		Të gjitha instalimet.
		h. Lyerja/veshja e bobinave.		Të gjitha instalimet.
		i. Veprimtari të tjera të lyerjes/veshjes përfshirë ato të metalit, plastikës, tekstileve (me përjashtim të stampimit/printimit me makinë shtypi rotativë të tekstileve), pëlhurave, filmit dhe letrës.		Të gjitha instalimet.
		j. Veshje e telave spirale.		Të gjitha instalimet.
		k. Përpunimi dhe saldimit i metaleve.		Me kapacitet të barabartë ose më shumë se 5 ton/ditë metal.
		l. Veprimtaritë e lyerjes /veshjes të aplikuara në sipërfaqe druri.		Të gjitha instalimet.
		l. Pastrimi kimik.		Me kapacitet të barabartë apo më shumë se 1 ton/ditë tekstile.
		m. Procesi i njomjes së drurit.		Konsumimi i solventëve është më i madh se 25 ton/vit.
		n. Veprimtaria e lyerjes /veshjes aplikuar në materiale lëkure.		Konsumimi i solventëve është më i madh se 10 ton/vit.
		o. Prodhimi i këpucëve.		Konsumimi i solventëve është më i madh se 5 ton/vit.
		p. Laminimi i drurit dhe plastikës.		Konsumimi i solventëve është më i madh se 5 ton/vit.
		q. Veshja me adeziv (material ngjitës).		Konsumimi i solventëve është më i madh se 5 ton/vit.
		r. Prodhimi i preparateve veshëse, llaqeve, bojërave dhe ngjitësve.		Konsumimi i solventëve është më i madh se 100 ton/vit.
		s. Shndërrimi i gomës.		Konsumimi i solventëve është më i madh se 15 ton/vit.
		t. Ekstraktimi i vajit vegjetal dhe yndyrës së kafshëve, si dhe veprimtaritë e rafinimit të vajit vegjetal.		Konsumimi i solventëve është më i madh se 10 ton/vit.
Prodhimi i produkteve plastike	7.13	Përveç rasteve të përmendura në veprimtaritë e tipit A ose tipit B të kësaj shtojce, prodhimi i produkteve prej plastike.		me kapacitet të barabartë ose më të madh se 50 ton/vit.
Akuakulturë intensive	8.1	Rritje intensive e peshqve.		Kapaciteti i prodhimit është i barabartë me 1000 ton/vit ose më pak se kaq, por gjithsesi më i madh se 100 tonë peshk/vit.
	8.2	Rritje e guaskave të detit.		Kapaciteti i prodhimit është i barabartë me 1000 ton/vit ose më pak se kaq, por gjithsesi më i madh se 100 tonë guaska deti/vit.



Industritë prodhuese të komponentëve elektrik	9.1	Prodhim i kompjuterëve dhe produkteve elektronike dhe optike n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.		Të gjitha instalimet.
	9.2	Prodhim i pajisjeve elektrike n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.		Të gjitha instalimet.
Industritë prodhuese të makinerive dhe pajisjeve	10.1	Prodhim i makinerive dhe pajisjeve n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.		Të gjitha instalimet.
	10.2	Prodhim i mjeteve motorike, trailerave dhe gjysmë-trailerve n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.		Të gjitha instalimet.
	10.3	Prodhim i mjeteve të tjera të transportit n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.		Të gjitha instalimet.
	10.4	Riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motoçikletave n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.		Kapaciteti është i barabartë me 5 ura ose më shumë se kaq.
Prodhimi i mobilie	11.1	Prodhim i mobilie, n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.		Kapaciteti i prodhimit më i madh se 1000 m ³ në vit.
Veprimtari të tjera	12.1	a. Kremimi i kufomave.		Të gjitha instalimet.
		b. Incinerimi i mbetjeve patologjike.		Të gjitha instalimet.
	12.2	Spitalet.		Të gjitha instalimet.
	12.3	Institucionet shëndetësore.		Çdo prodhues i mbetjeve spitalore i cili prodhon më shumë se 200 kg/vit mbetje spitalore të rrezikshme.
	12.4	Kapja e rrymave të CO ₂ .	Nga të gjitha instalimet e kategorisë A që synojnë depozitimin gjeologjik.	

Shënime për tabelën e veprimtarive të tipit A

1. Për kategorinë 4, Industria Kimike, “prodhim” do të thotë prodhim në shkallë industriale me anë të përpunimit kimik të substancave ose grupeve të substancave të listuara në kategoritë nga 4.1 deri 4.6.

2. Kimikatet organike bazë përfshijnë, por nuk mjaftohen në:

a) hidrokarburet e thjeshta (linear apo ciklik, të ngopura ose të pangopura, alifatik ose aromatik);

b) hidrokarburet që përmbajnë oksigjen si alkoole, aldehidet, ketonet, acidet karboksilike, esteret, acetatet, eteret, peroksidet, rezinat epokside;

c) hidrokarburet me bazë squfuri;

ç) hidrokarburet e hidrogjenuara si aminerat, amidet, përbërjet nitroze, përbërjet nitrore, ose përbërjet nitrite, përbërjet nitrile, cianatet, izocianatet;

d) hidrokarburet me përmbajtje fosfori;

dh) hidrokarburet halogjenike;

e) përbërjet organometalike;

ë) materialet me bazë plastike (polimeret, fibrat sintetike dhe fibrat me bazë celuloze);

f) gomat sintetike;

g) bojërat dhe pigmentet;

gj) lëndët tensioaktive.



3. Kimikatat inorganike bazë përfshijnë, por nuk mjaftohen në:

a) gaze, si amonium, klori ose gazi kloridrik, fluorët ose hidrogjen i fluoruar, oksidet e karbonit, përbërjet e squfurit, oksidet e azotit, hidrogjeni, dioksid squfuri, kloruri i karbonilit;

b) acidet, si acidi kromik, acidi hidrofluorik, acidi fosforik, acidi nitrik, acidi hidroklorik, acidi sulfurik, oleumi, acide sulfurore;

c) baza, si hidroksid amoni, hidroksid potasi, hidroksid natriumi;

ç) kripërat, si klorur amoni, klorat potasi, karbonat potasi, karbonat natriumi, perborate, nitrat argjendi;

d) jo metale, oksidet e metaleve ose përbërje organike të tjera si karbit, silikon, karburi i silicit.

4. Rikuperimi i mbetjeve të rrezikshme nënkupton veprimtaritë rikuperuse të mëposhtme siç përcaktohet në legjislacionin për menaxhimin e mbetjeve:

R1. Përdorim kryesisht si karburant ose mjet të ndonjë lloji tjetër për gjenerim energjie.

R5. Riciklimi ose marrja e materialeve inorganike, përfshirë gazifikimin dhe pirolizen për t'i përdorur si kimikate.

R6. Rigjenerim i acideve ose bazave.

R8. Rikuperim i komponentëve nga katalizatorët.

R9. Rirafinimi i vajit ose ripërdorime të tjera të vajit.

5. Asgjësim i mbetjeve jo të rrezikshme nënkupton veprimtaritë asgjësuese të mëposhtme siç përcaktohen në legjislacionin për menaxhimin e mbetjeve:

D8.

D9.

6. Trajtim sipërfaqësor i substancave, objekteve ose produkteve përfshin, por nuk mjaftohet në:

a) përpunimin;

b) stampimin/printimin;

c) lyerjen/veshjen;

ç) zhvajosjen;

d) mbrojtjen nga uji;

dh) kalibrimin/përpunimin me saktësi sipas përmasave;

e) bojatisjen/ngjyrosjen;

ë) pastrimin;

f) regjien/ngopjen/njomjen në thellësi.

DEKRET

Nr. 11488, datë 26.5.2020

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93, të Kushtetutës

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, ‘Për lejet e mjedisit’, të ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ Nr. 53/2020

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 431, DATË 9.6.2011, “PËR MBROJTJEN E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 29, pika 2 ndryshohet, si më poshtë:

“2. Dhënia e lejeve të mjedisit përcaktohet sipas një sistemi të përbërë prej dy nivelesh, mbështetur në madhësinë dhe llojin e veprimtarisë që ka nevojë të pajiset me leje, si dhe në mundësinë që ka ajo veprimtari të shkaktojë ndotje në atë masë që mund të sjellë dëm në mjedis e të rrezikojë shëndetin e njeriut:

a) kategoria e veprimtarive A, për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit A;



b) kategoria e veprimtarive B, për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit B.

Kategoritë e veprimtarive dhe kufijtë ndërmjet dy niveleve përcaktohen në ligjin për lejet e mjedisit.”.

Neni 2

Në nenin 62, pika 1, fjalët: “kryhet nga inspektorati shtetëror kompetent (më poshtë “Inspektorati”)” zëvendësohen me fjalët: “kryhet nga struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit”.

Neni 3

Kudo në tekstin e ligjit referencat “A, B dhe C” zëvendësohen me “A dhe B”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 30.4.2020

Shpallur me dekreten nr. 11489, datë 26.5.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

DEKRET

Nr. 11489, datë 26.5.2020

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93, të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 53/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011, ‘Për mbrojtjen e mjedisit’, të ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

LIGJ

Nr. 57/2020

PËR PYJET¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

1. Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës, të tokës, ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese, të ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik, si detyrime me interes kombëtar dhe ndërkombëtar.

2. Ligji kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të pyjeve, që mundëson një jetë më të mirë për shoqërinë sot dhe brezat e së ardhmes, duke rregulluar marrëdhëniet në sektorin e pyjeve, që kanë ndikim thelbësor në cilësinë e mjedisit natyror, në zhvillimin e bujqësisë, të energjisë dhe

¹ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me:

- Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 2173/2005, datë 20 dhjetor 2005 “Mbi ngritjen e një skeme licencimi FLEGT për importin e lëndës drusore në Komunitetin Europian”, të ndryshuar, Numri CELEX 32005R2173, Fletore Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 347, datë 30.12.2005, faqe 1–6.

- Rregulloren (BE) nr. 995/2010 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 20 tetor 2010, “Mbi përcaktimin e detyrimeve të operatorëve, të cilët vendosin në treg lëndë drusore dhe produkte të lëndëve drusore”, të ndryshuar, Numri CELEX 32010R0995, Fletore Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 295, datë 12.11.2010, faqe 23–34.

- Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) nr 607/2012, datë 6 korrik 2012, “Mbi rregullat e bollësishme në lidhje me sistemin e kujdesit të duhur dhe shpeshësinë dhe natyrën e kontrollave mbi organizatat monitoruese, siç parashikohet në Rregulloren (BE) nr. 995/2010, të Parlamentit Europian dhe të Këshillit “Mbi përcaktimin e detyrimeve të operatorëve që vendosin në treg lëndë drusore dhe produkte të lëndëve”, Numri CELEX 32012R0607, Fletore Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 177, datë 7.7.2012, faqe 16–18.



të turizmit, në uljen e varfërisë, zhvendosjen e popullsisë, zbutjen e konflikteve dhe të pabarazive me bazë sociale, gjinore, si dhe në sigurinë e vendit.

3. Ky ligj synon ruajtjen, shtimin e sipërfaqes dhe rritjen e volumit të përgjithshëm të fondit pyjor kombëtar, rregullimin e marrëdhënieve dhe garantimin e qëndrueshmërisë financiare, organizimin funksional në të gjitha nivelet e qeverisjes për shfrytëzimin dhe përdorimin e qëndrueshëm e të balancuar të burimeve pyjore përkundrejt mundësisë që pyjet kanë, pa cenuar vazhdueshmërinë e jetës dhe ciklin e pyllit. Po kështu, ligji siguron garantimin e shërbimeve cilësore duke synuar mbrojtjen e duhur, përmirësimin dhe rigjenerimin e hapësirës pyjore.

Neni 2

Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Objekti i këtij ligji përfshin rregullimin e administrimit të sektorit të pyjeve, organizimin institucional, rregullimin për përfitimet dhe shërbimet ndaj tij, për bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të angazhimeve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë, për të garantuar përmbushjen në vijimësi të funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale dhe kulturore në interes të të gjithë shoqërisë.

2. Ky ligj e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për pyjet si një ekosistem natyror në të gjitha elementet e tij, për qeverisjen e sektorit të pyjeve në të gjitha funksionet e tij, për të gjitha kategoritë dhe në të gjitha format e pronësisë.

3. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për aq sa është e mundur edhe për zonat e mbrojtura, faunën e egër, si dhe bimët mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjet përkatëse të posaçme.

4. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe në rastet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij ligji, pavarësisht se gjenden jashtë fondit pyjor kombëtar.

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

1. “Administrimi i pyjeve” është tërësia e masave organizative, teknike dhe financiare për zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre.

2. “Agjencia” është agjencia shtetërore përgjegjëse për pyjet.

3. “Agropylltari” janë sistemet e përdorimit të tokës, ku kulturat tradicionale, bujqësore ose foragjere kultivohen në të njëjtën sipërfaqe së bashku me drurët pyjorë ose me bimë të tjera drusore shumëvjeçare.

4. “ALFIS” (*Albanian Forest Information System*) është sistemi shqiptar i informacionit për pyjet.

5. “Bashki” është njësi e vetëqeverisjes vendore, që ka në pronësi sipërfaqe të fondit pyjor brenda kufijve territorialë administrativë të saj, e cila është përgjegjëse për administrimin e fondit pyjor publik.

6. “Biodiversitet” ka kuptimin sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e biodiversitetit.

7. “Burime gjenetike” janë drurë apo grumbuj pyjorë të përbërë nga lloje me potenciale të larta gjenetike aktuale apo për të ardhmen.

8. “Certifikatë origjine” është një dokument sipas formatit të miratuar me urdhër të ministrit, që deklaron se në cilin vend është prodhuar një mall ose produkt, si dhe përmban informacione për produktin, sasinë, destinacionin e tij dhe vendin e eksportit.

9. “Dëmtim i pyllit dhe mjedisit pyjor” janë dëmtime me pasojë humbjen e funksioneve të pjesëve të pyllit ose mjedisit pyjor dhe prishjen e ekuilibrave biologjikë natyrorë, si rezultat i ndërhyrjeve nga njeriu ose nga faktorë të tjerë natyrorë.

10. “DPP” është dokumenti i politikave për pyjet, ku politikat janë drejtimet kryesore ku fokusohet sektori, të cilat lidhen me vendimmarrjen për të ardhmen dhe realizojnë synimet e qeverisjes në përputhje me interesin publik e të grupeve të tjera të interesit.

11. “Druri dhe produktet e drurit” janë lënda drusore dhe produktet e drurit, të përcaktuara në kodin përkatës doganor dhe/ose në nomenklaturën e kombinuar të mallrave, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave sipas dispozitave të ligjit nr. 9461, datë 21.12.2005, “Për nomenklaturën e mallrave dhe tarifën e integruar doganore”, të ndryshuar, me përjashtim të produkteve të drurit apo komponentëve të këtyre produkteve, të prodhuara nga drurët ose produktet



e tyre, të cilat kanë përfunduar ciklin e jetës së tyre dhe në rast të kundërt do të asgjësoheshin si mbetje në kuptimin e pikës 31, të nenit 3, të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

12. “Ekonomi pyjore” është njësi bazë e organizimit të sipërfaqes së fondit pyjor kombëtar për qeverisjen e pyjeve dhe drejtimin, planifikimin e kontrollin e mbarështimit të pyjeve, që zakonisht përfshin një masiv pyjor, me kufij të qartë natyrorë.

13. “Ekspert i certifikuar” është personi i certifikuar nga ministria për ushtrimin e veprimtarisë së ekspertizës profesionale në pyje e kullota.

14. “Elementet e marketingut” të prodhimeve drusore dhe jodrusore nga pylli përfshijnë çmimin, llojin/et e produktit/eve, vendndodhjen dhe promovimin me mënyra e mjete të ndryshme.

15. “Ekosistem pyjor” është një kompleks dinamik i bashkësive të kafshëve, bimëve e mikroorganizmave dhe mjedisit të tyre abiotik, që bashkëveprojnë si një njësi funksionale, ku drurët janë komponenti kyç i sistemit dhe ku njerëzit, me nevojat e tyre kulturore, ekonomike, sociale dhe mjedisore, janë pjesë integrale e ekosistemeve pyjore.

16. “EUTR” ka kuptimin e rregullores së BE-së për lëndën drusore, e cila parashikon rregullat për të parandaluar shitjen në tregun e BE-së të lëndës së drurit të prerë në mënyrë të paligjshme, si dhe të produkteve të drurit të përfituara prej saj, duke u mbështetur në sistemin “kujdesi i duhur”.

17. “FLEGT” është plani i veprimtimit i BE-së, që synon të zvogëlojë prerjet ilegale duke forcuar menaxhimin e qëndrueshëm dhe ligjor të pyjeve, duke përmirësuar qeverisjen dhe duke promovuar tregtinë e drurit të prodhuar ligjërisht.

18. “Fond pyjor kombëtar”, që përfaqësohet nga fondi pyjor publik dhe privat, është sipërfaqja e mbuluar me pyje, shkurre, toka me bimësi pyjore, përfshirë edhe sipërfaqet e zhveshura (çeltirat, shkëmbinjtë, dunat dhe ranishtat), sistemet agropyjore, brezat mbrojtës, infrastrukturën përkatëse, si dhe pasuritë jopyjore bashkëshoqëruese, të cilat krijojnë një mjedis unik me pyjet e tokën pyjore.

19. “Grumbull pyjor” është njësi bazë për hartëzimin e pyllit, që përfaqësohet nga një grup i dendur drurësh pak a shumë homogjenë në lidhje

me përbërjen, dendësinë, madhësinë dhe habitatin e specieve.

20. “Infrastruktura pyjore” përfshin mjetet, pajisjet, programet dhe aplikacionet kompjuterike, zyrat, ndërtesat, struktura pune/akomodimi, stenda informacioni, fidanishtet, magazinat, depot, rrjetin rrugor pyjor, teleferikët pyjorë, traktorët, makinat, motorët, radiot e antenat e radiokomunikimit, pritrat, pendat, çezmat, rrethimet e gardhimet, tabelat, shenjat e ndryshme treguese e sinjalizuese, ato të mbarështimit pyjor, rrjetet e shërbimeve ujësjellës, elektrike, telekomunikacion etj., si dhe lehtësitë e tjera të ngritura në fondin pyjor publik për informimin dhe pritjen e vizitorëve.

21. “Inventarizimi kombëtar i pyjeve” është procesi që realizon grumbullimin dhe vlerësimin e të dhënave për shtrirjen dhe gjendjen e fondit pyjor kombëtar, të cilat shërbejnë për hartimin e politikave në fushën e pyjeve, për zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumëfunksional të tyre.

22. “Individ” në kuptim të këtij ligji është banori/ët e zonës me qëndrim të përhershëm në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

23. “KKT” është Këshilli Kombëtar i Territorit.

24. “KP” është Këshilli i Pyjeve.

25. “Kujdesi i duhur” është sistemi i kujdesit të nevojshëm për parandalimin e tregtimit të paligjshëm të drurit dhe prodhimeve që rrjedhin prej tij.

26. “Mbarështimi i pyjeve” është planifikimi afatgjatë për pyjet, publike dhe private, i cili kryhet në bazë të kriterëve të caktuara për grumbullimin e informacionit për situatën/gjendjen faktike dhe përcaktimin e objektivave e masave të nevojshme, në funksion të statusit të dhënë, me synim përmirësimin e funksioneve ekologjike, ekonomike e sociale, duke zbatuar dhe harmonizuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm me nevojat e administruesve, pronarëve privatë dhe përdoruesve të tyre.

27. “Mbrojtja e pyjeve dhe e tokës pyjore” është veprimtaria për parandalimin e degradimit të pyjeve dhe të tokave pyjore nga faktorët njerëzorë e natyrorë, me synim garantimin e ripërtëritjes dhe përmirësimin e burimeve pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese dhe të mjedisit pyjor në tërësi.

28. “Ministër” është ministri përgjegjës për pyjet.

29. “Ministria” është ministria përgjegjëse për pyjet.



30. “Mundësia vjetore e shfrytëzimit” është sasia e vëllimit drusor, e përcaktuar në një plan mbarështimi të miratuar, që mund të pritët çdo vit ose në mënyrë periodike në një ekonomi pyjore përgjatë një periudhe të dhënë. Pjesë e mundësisë vjetore të shfrytëzimit bëhen edhe sasi të materialit drusor të dëmtuar për shkaqe natyrore dhe/ose të tjera (furtuna, ngrica, dëbora, zjarre, sëmundje, dëmtues etj.), të cilat kanë prioritet shfrytëzimi, duke mbajtur në ekuivalencë mundësinë vjetore të planifikuar nga planet e mbarështimit.

31. “Ngastër” është emërtimi i sipërfaqes pyjore, me kufij të qartë natyrorë, që krijohet nga ndarja në pjesë e një ekonomie pyjore dhe që shërben si njësi bazë për drejtimin, organizimin, planifikimin dhe kontrollin e mbarështimit.

32. “Nënngastër” është një njësi sipërfaqeje me madhësi minimale 0.5 ha, që shërben për vlerësimin e grumbujve pyjorë, planifikimin dhe kontrollin e trajtimeve të njëjta silvikulturore.

33. “Organizimi institucional” është realizimi i atij funksioni të qeverisjes, që garanton institucione funksionale, aktivitet të efektshëm të orientuar drejt rezultateve, akumulimin e dijes institucionale, si dhe infrastrukturën e nevojshme për përmbushjen e përgjegjësisë.

34. “Pasuri pyjore” është tërësia e elementeve natyrore të një sipërfaqeje pylli a toke pyjore, me vlera të përdorshme për nevojat e shoqërisë, në të cilat përfshihen toka, drurët, uji, bimësia e shumëllojshme jopyjore dhe gjallesat e egra.

35. “PKP” është Programi Kombëtar i Pyjeve.

36. “PKSP” është Plani Kombëtar Sektorial i Pyjeve, që hartohet dhe miratohet sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

37. “Plani i mbarështimit” është dokumenti bazë për mbarështimin e një ekonomie pyjore, që përmban analizën e gjendjes së pyjeve, përcakton objektivat që duhet të realizohen në funksion të statusit që kanë, si dhe planifikon masat për trajtimin e tyre dhe ndërhyrjet për vitet e ardhshme.

38. “Plan përmirësimi pyjor” është procesi i planifikimit dhe organizimit të objektivave të planit të mbarështimit, në masa konkrete silvoteknike, që synojnë përmirësimin e gjendjes së pyllit.

39. “Plani operacional vjetor” është dokumenti i planifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve nga aktivitetet në pyjet publike, buxheti i shtetit, donacionet ose grantet e ndryshme për realizimin e

punimeve të përcaktuara ose rekomanduara nga planet e mbarështimit, të veprimtarive për zhvillimin dhe mbrojtjen e fondit pyjor, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së nevojshme, si dhe për qëllime të tjera të parashikuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

40. “Prerje kulturore” është tërësia e punimeve që zbatohen periodikisht në një grumbull pyjor nga çasti i krijimit deri në shfrytëzimin me synim përmirësimin dhe sigurimin e vazhdimësisë së prodhimit.

41. “Prerje për shfrytëzimin e pyjeve” janë punimet për nxjerrjen e lëndës drusore nga pyjet dhe shkurret, që kanë arritur moshën e shfrytëzueshmërisë, me qëllimin kryesor heqjen e gjeneratës së vjetër dhe krijimin e kushteve për instalimin në rrugë natyrore të gjeneratës së re, gjatë fazave të prerjeve, ose me pyllëzime artificiale për llojet që trajtohen me prerje rrah, si dhe për vlerësimin ekonomik të materialit drusor të përfituar nga prerjet.

42. “Prerje rrah” quhet prerja rrafsh me tokën e të gjithë drurëve në një pjesë pylli.

43. “Prodhimet pyjore jodrusore” përfshijnë lulet, frutat, farat, sythat, bisqet, degët, drurët dekorativë, shpatullat, kalemat, gjethet, halat, boçet, zhukat, kallamishtet, rrëshirën, plisat, barin, rrënjët, zhardhokët, kërpudhat, myshqet, humusin, lëgushat, torfat, dheun, gurët, zhavorrin dhe rërën.

44. “Pronar privat i pyllit” është personi fizik sipas përcaktimeve të Kodit Civil dhe/ose personi juridik, që gëzon të drejtat ekskluzive të pronësisë, gëzimit dhe disponimit të pyllit brenda kufijve të caktuar nga ligji.

45. “Pyje prodhuese”, funksioni i të cilave është prodhimi i lëndës drusore dhe prodhimeve të tjera jodrusore.

46. “Pyje mbrojtëse”, funksioni i të cilave është kryesisht mbrojtja e tokës nga gërryerja, rrëshqitjet, përmytjet, mbrojtja e tokave bujqësore nga erërat, stabilizimi dhe përmirësimi i cilësisë dhe sasisë së regjimit ujor.

47. “Pyje të mbrojtura”, funksioni i të cilave është përmbushja e qëllimeve të përcaktuara në statusin e dhënë.

48. “Pyll” është sipërfaqja e tokës më e madhe se 0.5 ha, e mbuluar me drurë më të lartë se 5 metra dhe me shkallë mbulimi mbi 10 për qind, ose me drurë të aftë për të arritur këto pragje.



49. “Pyllëzim” është mbjellja me fidanë ose me farë e një sipërfaqeje pyjore, ose që nuk ka qenë asnjëherë e veshur me pyje (inproduktive/tjetër).

50. “Pyll i lartë (trungishte)” është pylli i përbërë nga drurë me prejardhje nga fara.

51. “Pyll i ulët (cungishte)” është pylli i përbërë nga drurë me prejardhje vegjetative, nga lastarë.

52. “Pyll i virgjër” është pylli natyror i pacenuar nga veprimtaria njerëzore.

53. “Qeverisja e pyjeve” është garantimi i mbarështimit, i të drejtave e detyrimeve dhe financimit të pyjeve, ngritja dhe vënia në eficientë e organizimit funksional, menaxhimi i përfitimeve nga shfrytëzimi i fondit pyjor kombëtar, si dhe realizimi i shërbimeve të nevojshme ndaj pyjeve.

54. “Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP)” është regjistri zyrtar i të dhënave kadastrale të fondit pyjor kombëtar, i organizuar në nivel qendror, rajonal dhe vendor, në të cilin regjistrohen të gjitha informacionet bazë dhe ndryshimet periodike të ndodhura në pronësinë, të drejtat reale, pozicionin hartografik, sipërfaqe, volum etj., shoqëruar me sistemin e informacionit gjeografik (GIS), i nevojshëm për administrimin dhe planifikimin e pyjeve.

55. “Rezerva strategjike të lëndës drusore” janë sipërfaqe pyjore të vëna në ruajtje për të përballuar nevojat e krijuara nga ngjarje madhore.

56. “Ripyllëzim” është mbjellja e drurëve pyjorë në një sipërfaqe të përkufizuar “pyll” ose “tokë me bimësi pyjore”, në të cilën, për arsye të ndryshme, nuk është siguruar ripërtëritja në rrugë natyrale, ose ripërtëritja është dëmtuar dhe nuk garanton zhvillimin e grumbullit të ri.

57. “Ruajtje in-situ” janë masat menaxhuese, të nevojshme për të ruajtur burimet gjenetike pyjore në habitatet e tyre.

58. “Sektori i pyjeve” është tërësia e integruar e fondit pyjor kombëtar dhe e dinamikave që zhvillohen në të, e grupeve të interesit, rregullave, burimeve dhe inputeve të nevojshme, strukturave, aktivitetit, shërbimeve që kryhen në pyje, dhe ndërveprimi i këtyre elementeve si një sistem i integruar funksional që garanton pyjet që duam.

59. “Sistemi organizativ i sektorit të pyjeve” është tërësia e integruar e institucioneve, aktiviteteve, dijës dhe infrastrukturës në shërbim të tyre në të gjitha nivelet e sektorit.

60. “Shërbimet e ekosistemit” janë përfitimet që marrin njerëzit nga ekosistemet dhe përfaqësojnë:

shërbime të furnizimit për ushqim dhe ujë; shërbime rregullatore për parandalimin e përmbajtjeve, thatësisë, sëmundjeve, degradimit të tokës (mbrojtja e tokës nga gërryerja, rrëshqitjet, mbrojtja e tokave bujqësore nga erërat, përthithja e karbonit, zhvillimi i faunës), të cilat lidhen edhe me ndryshimet klimaterike dhe mbrojtjen e biodiversitetit; shërbime mbështetëse për tokëformimin dhe ciklin e lëndëve ushqyese; shërbime kulturore që lidhen me rekreacionin dhe përfitime të tjera jomateriale.

61. “Shkurre” janë bimë drusore shumëvjeçare, përgjithësisht me lartësi mbi 0.5 metra dhe më pak se 5 metra, zakonisht pa një trung dhe kurorë të përcaktuar.

62. “Tokë me bimësi pyjore” janë terrene me drurë dhe shkurre me madhësi mbi 0.5 ha, me një shkallë mbulimi deri 10 për qind.

63. “Zhvillimi i qëndrueshëm i pyjeve” është procesi i administrimit dhe shfrytëzimit të pyjeve, në mënyra dhe intensitete të tilla që të ruajnë larminë e tyre biologjike, prodhimtarinë dhe kapacitetet ripërtëritëse, për të përmbushur tani dhe në të ardhmen funksionet ekologjike, ekonomike dhe shoqërore, pa shkaktuar dëme në ekosistemet e tjera, si në nivel vendor, kombëtar, rajonal dhe botëror.

KREU II

SEKTORI I PYJEVE

Neni 4

Klasifikimi i pyjeve dhe fondi pyjor kombëtar

1. Në varësi të statusit që kanë, funksionit që përmbushin, shfrytëzimit dhe përdorimit që i nënshtrohen, moshës, llojit të drurëve dhe bimësisë nga të cilat përbëhen, pyjet klasifikohen ose kategorizohen si më poshtë:

a) referuar tipologjisë, pyjet kategorizohen në pyll i lartë (trungishte), pyll i ulët (cungishte) dhe shkurre;

b) në varësi të funksionit që caktohen për të përmbushur, pyjet klasifikohen në pyje mbrojtëse, pyje të mbrojtura dhe pyje prodhuese.

2. Klasifikimi i pyjeve bëhet mbi bazën e kritereve të përcaktuara me udhëzim të ministrit.

3. Fondi pyjor kombëtar përbëhet nga:

a) pyjet sipas përkufizimit në këtë ligj, pyjet në parqet kombëtare, rezervat natyrore dhe zona të



tjera të mbrojtura, terrenet pyjore pa bimësi për shkak të fatkeqësive natyrore, të cilat pritet të rigjenerohen brenda disa viteve, brezat pyjorë mbrojtës nga era, nga zjarret, si dhe korridoret me drurë me sipërfaqe më të madhe se 0,5 hektar;

b) tokat me bimësi pyjore, si dhe sipërfaqet e zhveshura, si: çeltirat, shkëmbinjtë dhe ranishtet që ndodhen në pyje;

c) flora dhe fauna e egër, bimësia barishtore natyrore me vlera foragjere, mjekësore, eterovajore e tanifere, prodhimet e tjera pyjore e jopyjore;

ç) infrastruktura pyjore.

4. Në fondin pyjor kombëtar nuk përfshihen, por administrohen sipas dispozitave të këtij ligji:

a) drurët e veçantë dhe grupet e drurëve, kudo që ndodhen, kur sipërfaqja që mbulojnë nuk plotëson kriterin për t'u konsideruar pyll, si dhe ata që ndodhen në një rresht rreth tokave bujqësore, anës rrugëve, kanaleve, vijave të ujit;

b) parqet urbane dhe sipërfaqet e pyllëzuara pranë monumenteve dhe varrezave, pavarësisht nga sipërfaqja e tyre;

c) drurët dhe shkurret industriale, që gjenden jashtë fondit pyjor kombëtar.

5. Në fondin pyjor kombëtar nuk bëjnë pjesë grumbujt me drurë në sistemet e prodhimit bujqësor, të tilla si parcelat me drurë frutorë, ullishtet dhe sistemet e tilla ku kulturat bujqësore rriten nën kurorat e drurëve.

Neni 5

Kufijtë dhe ndryshimet në fondin pyjor kombëtar

1. Fondi pyjor kombëtar ndahet në ekonomi pyjore, ngastra dhe nënngastra. Kufijtë e fondit pyjor kombëtar janë të përhershëm, të përcaktuar qartë, të shënuar në terren dhe të hedhur në hartë.

2. Ndalohet prishja, fshirja ose dëmtimi i shenjave kufidëftuese, gjeodezike e topografike, i tabelave paralajmëruese apo treguese të vendosura në fondin pyjor kombëtar.

3. Sipërfaqja e fondit pyjor kombëtar të ruhet dhe të mos zvogëlohet, edhe në rastet e lejuara nga ligji për heqjet nga fondi pyjor kombëtar të garantohet zëvendësimi i tij.

4. Ndryshime (heqje/shtesa) të sipërfaqeve nga/në fondin pyjor kombëtar bëhen me:

a) miratimin e ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha;

b) vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1 ha deri në 10 ha;

c) ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 10 ha.

Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit.

5. Subjektet përfituese, për të cilat është miratuar ndryshimi i destinacionit të fondit pyjor kombëtar, detyrohen të paguajnë paraprakisht kostot e përlogaritura për pyllëzimin kompensues përkatës, përfshirë kostot e mirëmbajtjes së nevojshme pas mbjelljes që garanton zënien efektive të tyre, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave dhe detajimit me udhëzim të ministrit. Subjektet që ushtrojnë këto aktivitete të lejuara nga ligji, detyrohen për rehabilitimin e sipërfaqes në të cilën është ushtruar aktiviteti përkatës.

6. Sipërfaqet e pyjeve që zihen nga ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e fondit pyjor kombëtar, me natyrë të përkohshme, nuk konsiderohen ndryshime destinacioni.

7. Në fondin pyjor kombëtar ndalohet ndryshimi i destinacionit:

a) të sipërfaqeve të djegura në fondin pyjor;

b) nëse cenon ruajtjen e biodiversitetit, stabilitetin e terrenit, regjimin e ujit, mbrojtjen nga rënia e gurëve dhe ortekëve, ruajtjen e peizazhit, si dhe rolin e pyjeve për mbrojtjen nga era.

8. Ndryshimet në sipërfaqe, destinacion dhe çdo elementi që lidhet me to, duhet të pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor (RKFP) pas miratimit nga organi kompetent dhe hyrjes në fuqi, sipas përcaktimeve të këtij neni.

Neni 6

Regjistri Kombëtar, inventarizimi dhe Rrjeti i Monitorimit të Fondit Pyjor Kombëtar

1. Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP) është regjistri zyrtar që ngrihet dhe mirëmbahet nga agjencia, në të cilin pasqyrohet tërësia e informacioneve kadastrale të nevojshme dhe e ndryshimeve periodike për çdo njësi të fondit pyjor kombëtar. Struktura e RKFP-së, kriteret teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të



ndryshimeve, mënyra e mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal dhe qendror, informacioni që duhet regjistruar, si dhe afatet e përgatitjes e të raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

2. Inventarizimi kombëtar i pyjeve realizon grumbullimin dhe vlerësimin e të dhënave për shtrirjen dhe gjendjen e fondit pyjor kombëtar. Ai synon vlerësimin e ndryshimeve hapësinore dhe kohore të fondit pyjor kombëtar, sigurimin e të dhënave me karakter sasior e cilësor, nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm e ciklik, duke mundësuar përditësimin periodik të të dhënave. Cikli i plotë i riinventarizimit kombëtar të pyjeve është 8-vjeçar, duke inventarizuar 25% çdo 2 vjet të fondit pyjor. Agjencia ka përgjegjësinë për hartimin e metodologjisë, organizimin dhe drejtimin e punës për inventarizimin e pyjeve në nivel kombëtar”.

3. Agjencia organizon Rrjetin e Përhershëm të Monitorimit të Fondit Pyjor Kombëtar, si pjesë e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Gjendjes së Mjedisit për të cilin:

a) programi i monitorimit, metodika për grumbullimin, analizimin, interpretimin, organizimin e të dhënave dhe raportimin e tyre, si dhe kriteret dhe indikatorët për vlerësimin e secilit komponent të përfshirë në monitorim hartohen nga agjencia, në konsultim me institucionet shkencore;

b) programi përfshin të gjithë komponentët që i nënshtrohen monitorimit, tërësinë e elementeve të nevojshme për secilin prej tyre, si dhe të dhënat që mundësojnë paraqitjen e gjendjes dhe prirjeve të proceseve për çdo komponent;

c) agjencia përpunon dhe nxjerr rezultatet e monitorimit, si dhe harton e publikon raportin vjetor për gjendjen e fondit pyjor si pjesë të raportit për gjendjen e mjedisit.

Neni 7

Grupet e interesit në sektorin e pyjeve

1. Grupet kryesore të interesit në sektorin e pyjeve përfshijnë institucionet qendrore dhe vendore, të cilat kanë përgjegjësi për zhvillimin e sektorit dhe mbarështimin e pyjeve, pronarët privatë të pyjeve, organizimet e shoqërisë civile, që operojnë në fushën e mjedisit dhe të pyjeve, profesionistët e fushës, shoqatat apo format e tjera

të organizimit kolektiv të përdoruesve të pyjeve, bizneset që shfrytëzojnë produktet pyjore, si dhe komunitetet në zonat rurale, jeta e të cilëve është drejtpërsëdrejti e lidhur me pyjet.

2. Grupet e ndryshme të interesit bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë veprimtarinë e tyre në funksion të zhvillimit të sektorit, si dhe ofrojnë kontributin në përputhje me përcaktimet ligjore dhe interesat e tyre të ligjshme përgjatë proceseve të hartimit dhe të zbatimit të kuadrit ligjor dhe dokumenteve planifikuese për pyjet.

3. Institucionet përgjegjëse për pyjet garantojnë informimin dhe ndërgjegjësimin e grupeve të interesit për rëndësinë e pyjeve, politikat dhe masat e ndërmarra në lidhje me mbrojtjen, administrimin dhe mbarështimin e tyre. Agjencia garanton konsultimin, koordinimin dhe angazhimin e grupeve të interesit në nivel kombëtar, duke harmonizuar përpjekjet dhe kontributin e tyre drejt përmirësimit të gjendjes së pyjeve.

Neni 8

Këshilli i Pyjeve

1. Nën orientimin dhe koordinimin e ministrisë, me urdhër të ministrit ngrihet Këshilli i Pyjeve (KP), që përbëhet nga profesionistë të fushës, përfaqësues të institucioneve akademike, të shoqërisë civile, organizimeve të përdoruesve të pyjeve, biznesit, si dhe individë me kontribut të veçantë në sektorin e pyjeve, i cili funksionon si një forum që iu mundëson aktorëve të parashtrojnë qëndrimet dhe interesat e tyre në kuadër të harmonizimit dhe të ekuilibrit të interesave sektoriale, duke ofruar orientim, këshillim dhe opinione profesionale, jo të detyrueshme për institucionet, për qeverisjen e pyjeve.

2. Rregullorja e KP-së hartohet nga ministria në bashkëpunim me përfaqësues të grupeve të interesit dhe miratohet nga ministri.

Neni 9

Qeverisja e sektorit të pyjeve

1. Parimet kryesore që udhëheqin qeverisjen e pyjeve janë:

a) integrimi i elementeve të qeverisjes përkundrejt funksioneve dhe qëllimit;

b) ndarja e drejtë në raport me përfitimet, përgjegjësitë, nevojën dhe mundësitë;



c) qëndrueshmëria midis përdorimit, kohës, vlerës dhe cilësisë;

ç) qëndrueshmëria në raportet kosto-përfitim, të shtrira në kohë dhe për brezat e ardhshëm.

2. Vlerat bazë ku mbështetet qeverisja e pyjeve janë si më poshtë:

a) potenciali ripërtëritës i vetë pyjeve, si një sistem që zhvillohet dhe ripërtërihet;

b) pasuritë natyrore me kushtet klimatike të favorshme, burimet ujore dhe diversitetin e tyre;

c) sipërfaqja e konsiderueshme e fondit pyjor kombëtar;

ç) tradita e gjatë dhe eksperiencia e grumbulluar në pylltari.

Neni 10

Politikat dhe Programi Kombëtar i Pyjeve

1. Politikat në sektorin e pyjeve përcaktohen në dokumentin e politikave për pyjet dhe janë në përputhje e zbërthejnë më tej politikat kombëtare, duke orientuar administrimin e sektorit, organizimin institucional, përfitimet nga shfrytëzimi i fondit pyjor kombëtar dhe shërbimet ndaj pyjeve.

2. Dokumenti i politikave për pyjet (DPP) është plani i nivelit më të lartë strategjik, që lidh qëllimin dhe vizionin e qeverisjes me masat dhe aktivitetet konkrete për realizimin e tyre. DPP-ja shërben si bazë për hartimin e strategjive dhe programeve të zhvillimit, hartimin dhe zbatimin e rregullave, orientimin e buxheteve, ngritjen dhe përmirësimin e institucioneve përgjegjëse. DPP-ja miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

3. Programi Kombëtar i Pyjeve (PKP) është dokument planifikimi strategjik, që realizohet me një proces pjesëmarrës, gjithëpërfshirës, ndërsektorial, për përmirësimin e mëtejshëm të qeverisjes së qëndrueshme të pyjeve. PKP-ja reflekton nevojat dhe prioritetet kombëtare dhe siguron përputhjen me legjislacionin, politikat dhe strategjitë kombëtare.

4. PKP-ja miratohet në zbatim të politikave dhe përditësohet në vazhdimësi në kontekstin e zhvillimeve të përgjithshme e të veçanta të vendit dhe të sektorit të pyjeve, si edhe ato që burojnë prej marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë. PKP-ja miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

5. Monitorimi dhe kontrolli i zbatimit të DPP-së dhe PKP-së bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ciklike nga strukturat përgjegjëse sipas këtij ligji, duke bërë vlerësimin e ecurisë dhe ndryshimin e tyre çdo 3 vjet dhe rishikimin tërësor çdo 10 vjet.

6. Të gjitha institucionet apo autoritetet e tjera publike, veprimtaria e të cilave lidhet apo ndikon në fondin pyjor kombëtar, detyrohen që përpara miratimit të nismave apo akteve planifikuese të sektorëve që mbulojnë të bashkërendojnë dhe të konsultohen.

KREU III

ADMINISTRIMI I SEKTORIT TË PYJEVE

Neni 11

Mbarështimi i pyjeve

1. Mbarështimi i pyjeve realizohet në përputhje me politikat dhe Programin Kombëtar të Pyjeve, duke garantuar ruajtjen, zhvillimin dhe ripërtëritjen e fondit pyjor kombëtar, sigurimin e kushteve për shfrytëzimin e tij në përputhje me prioritetet kombëtare. Mbarështimi i pyjeve përshtatet dhe plotësohet në përputhje me ndryshimet e gjendjes së fondit pyjor kombëtar, si dhe me ndryshimet shoqërore dhe ekonomike të vendit.

2. Planifikimi i funksioneve, i produkteve dhe i punimeve në fondin pyjor kombëtar bëhet nëpërmjet:

a) Planit Kombëtar Sektorial të Pyjeve (PKSP), si dokumenti afatgjatë dhe kuadër i planifikimit në pyje, që përcakton zonimin (hartografimin) e përgjithshëm funksional të fondit pyjor kombëtar, veprimtaritë dhe aktivitetet e lejuara që zhvillohen në të, aktivitetet që realizohen në përputhje me kufizime të caktuara, si dhe ato të ndaluara. Ky dokument hartohet nga ministria dhe miratohet nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT);

b) planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore, si dokument bazë afatgjatë për pyjet, për realizimin e qeverisjes, zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre, i vlefshëm për një periudhë 10-vjeçare. Planet e mbarështimit hartohen nga pronarët përkatës sipas formës së pronësisë, bazuar në metodikat/udhëzuesit e përgatitur nga ministria, nëpërmjet ekspertëve të certifikuar të fushës ose strukturave pyjore. Për të gjitha format e pronësisë, planet e mbarështimit miratohen nga ministri. Përgjashtimisht për bashkitë, miratimi i planit të



mbarështimit shoqërohet me miratimin paraprak të këshillit bashkiak përkatës;

c) planeve operacionale vjetore, të cilat garantojnë planifikimin e punimeve, zbatimin, kontrollin apo monitorimin e planeve të mbarështimit dhe për fondin pyjor publik e privat, brenda territorit administrativ të bashkisë dhe miratohen nga kryetari i bashkisë në përputhje me planin e mbarështimit.

3. Dokumentet planifikuese të përmendura në pikën 2 të këtij neni:

a) hartohen në përputhje me parimet e pjesëmarrjes së publikut dhe mbështeten në objektivat e zhvillimit strategjik, social dhe mjedisor të zonës;

b) zbatohen, sipas rastit, nga strukturat përgjegjëse për pyjet në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara në këtë ligj dhe me detyrimet që këto plane parashikojnë, ku agjencia monitoron në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e tyre, si dhe raporton para ministrit;

c) rishikohen apo përditësohen, sipas nevojës, nga strukturat përgjegjëse të parashikuara më lart dhe ndjekin të njëjtin proces miratimi.

Neni 12

Të drejtat dhe detyrimet mbi pyjet

1. Për shkak të vlerës dhe rëndësisë, pyjet janë pasuri kombëtare dhe trajtohen si të tilla. Funkcioni i pyjeve si një e mirë publike prevalon mbi çdo interes tjetër të çdo subjekti dhe garantohet me vendosjen e kufizimeve përkatëse. Institucionet shtetërore garantojnë trajtimin prioritar të pyjeve sipas statusit të tyre “pasuri kombëtare” dhe interesit publik që ato përmbushin.

2. E drejta e pronësisë mbi fondin pyjor kombëtar nënkupton mundësinë për të gëzuar dhe disponuar pjesë apo sipërfaqe të fondit pyjor kombëtar, brenda kufizimeve të vendosura në këtë ligj, në përputhje me funksionin dhe destinimin e fondit pyjor kombëtar. Sipas pronësisë, fondi pyjor kombëtar ndahet në fond pyjor publik dhe privat:

a) fondi pyjor në pronësi publike përfshin të gjitha kategoritë e fondit pyjor kombëtar, që janë në pronësi të institucioneve shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, dhe ndahet në fond pyjor në pronësi të bashkive për sipërfaqet brenda kufijve të tyre administrativë, si dhe në fond pyjor në pronësi të ministrisë, ku përfshihen pyjet në zonat e

mbrojtura, që gjenden nën administrimin e agjencisë përgjegjëse për zonat e mbrojtura;

b) fondi pyjor në pronësi private përbëhet nga sipërfaqet pyjore të kthyer pronarëve privatë në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe nga grupet e drurëve apo pyllëzimet që ekzistojnë apo krijohen në tokat në pronësi private.

3. E drejta e shfrytëzimit të fondit pyjor kombëtar nënkupton të drejtën që ka fituar subjekti, i cili ka plotësuar kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, për të përfituar ekonomikisht nëpërmjet aktiviteteve dhe veprimtarive të ndryshme në fondin pyjor përmes shfrytëzimit dhe shitjes së materialit drusor, prodhimeve jodrusore nga pylli, zhvillimit të gjetisë etj. Në lidhje me të drejtën e shfrytëzimit:

a) subjektet e pajisura me leje/autorizime, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, lejet dhe autorizimet, të përfshira në kategorinë III.4, për ushtrim aktiviteti për shfrytëzimin e fondit pyjor kombëtar apo ndërmarrjet e specializuara të ngritura nga bashkitë për këtë qëllim detyrohen:

i. ta ushtrojnë atë në përputhje me kriteret për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim;

ii. të kryejnë punimet sipas përcaktimeve në projektet tekniko-ekonomike të miratuara nga agjencia;

iii. të respektojnë detyrimet apo kushtëzimet e vendosura në këtë ligj, në aktet nënligjore, në planet e mbarështimit dhe në kontratat e nënshkruara me strukturat përgjegjëse, që administrojnë fondin pyjor kombëtar;

b) bashkitë përdorin pjesë të të ardhurave të realizuara nga shfrytëzimi i fondit pyjor brenda kufijve të tyre administrativë për të financuar programe sociale në ndihmë të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike.

4. E drejta e përdorimit mbi pyjet nënkupton mundësinë e personit për ta përdorur pjesën e fondit pyjor kombëtar të dhënë në përdorim dhe për të gëzuar frytet që rrjedhin prej tij, në masën që ka nevojë për vete dhe për familjen e tij, përkundrejt punës së tij në kryerjen e shërbimeve përmirësuese të atij pylli, si dhe pa cenuar mundësinë që kanë pyjet dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Në lidhje me të drejtën e përdorimit:

a) familjet dhe komunitetet me banim të përhershëm në zonat rurale kanë të drejtën e përdorimit të sipërfaqeve të fondit pyjor kombëtar

në afërsi të fshatit për përmbushjen e nevojave vetjake;

b) e drejta e përdorimit të fondit pyjor kombëtar për nevojat e komuniteteve rurale bazohet në respektimin e parimit të barazisë gjinore në përputhje me politikat për zhvillimin rural, duke njohur përgjegjësitë për ruajtje dhe kujdesin ndaj pyllit;

c) kriteret dhe rregullat për dhënien në përdorim të fondit pyjor përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Administrimi i fondit pyjor kombëtar bëhet sipas dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, pavarësisht formës së pronësisë.

6. Kalimi i të drejtave dhe detyrimeve mbi fondin pyjor kombëtar dhe pa ndryshuar destinimin e tij bëhet në përputhje me Kodin Civil, legjislacionin në fuqi për licencat/lejet/autorizimet, si dhe sipas mënyrave dhe kushteve të përcaktuara me ligje të veçanta, duke përmbushur detyrimet e mëposhtme:

a) personat fizikë ose juridikë, që kanë në pronësi, administrim, shfrytëzim ose përdorim pyje, grumbuj drurësh ose dru pyjorë, brenda ose jashtë fondit pyjor kombëtar, janë të detyruar të zbatojnë planet e mbarështimit të pyjeve;

b) subjektet kanë detyrimin që të regjistrojnë pranë RKFP-së të drejtat dhe detyrimet mbi fondin pyjor kombëtar, sipas këtij ligji, si dhe çdo ndryshim të tyre.

7. Të drejtat e subjekteve për pasuritë e fondit pyjor kombëtar, si dhe kufizimet e tyre, së bashku me infrastrukturën përkatëse, regjistrohen nga vetë subjektet në institucionin përgjegjës për regjistrimin e pasurive, sipas dispozitave në fuqi të legjislacionit përkatës për regjistrimin e pasurive.

Neni 13

Financimi i sektorit të pyjeve

1. Financimi i sektorit të pyjeve bazohet në parimin e qëndrueshmërisë, i cili nënkupton ekuilibrimin e shpenzimeve që kryhen për ruajtjen, rigjenerimin dhe zhvillimin e fondit pyjor kombëtar me të ardhurat që sigurohen nga shfrytëzimi i tij dhe shërbimet që ofron. Të ardhurat nga aktivitetet në fondin pyjor kombëtar përdoren vetëm dhe në funksion të rimëkëmbjes së pyjeve.

2. Burimet e financimit të sektorit të pyjeve janë:

a) buxheti i shtetit;

b) buxheti i njërive të vetëqeverisjes vendore;

c) donacionet dhe grantet e ndryshme;

ç) të ardhurat nga të gjitha aktivitetet e mundshme në fondin pyjor.

3. Të ardhurat e krijuara sipas përcaktimeve në shkronjën “ç” të pikës 2, përdoren 100% nga strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki, kryesisht për investime në fondin pyjor.

4. Tarifat për të gjitha veprimtaritë që zhvillohen në sektorin e pyjeve, mënyra dhe procedura e mbledhjes së tyre miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. Organi përgjegjës për vjeljen e të ardhurave në sektorin e pyjeve është struktura përgjegjëse për pyjet në bashki/zonat e mbrojtura, ndërsa procedura e mbledhjes së tyre apo ekzekutimit të detyrueshëm rregullohet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

5. Të ardhurat nga përdorimi i fondit pyjor në zonat e mbrojtura do të përdoren sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura.

6. Ministria, bashkitë dhe agjencia shtetërore përgjegjëse për pyjet planifikojnë çdo vit fondet e nevojshme për fondin pyjor publik, në përputhje me legjislacionin për buxhetin e shtetit dhe financat publike, në nivel qendror apo rregullimin e buxhetimit në nivel vendor.

7. Burimet financiare në dispozicion të ministrisë (përfshirë agjencitë) dhe të bashkive për pyjet publike përdoren për:

a) mbrojtjen e pyjeve, florës, faunës së egër, mjedisit dhe biodiversitetit, si dhe parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve, dëmtuesve dhe zjarreve;

b) punimet e mirëmbajtjes dhe të përmirësimit të gjendjes së pyjeve, ndërtimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës pyjore;

c) investime të ndryshme në fondin pyjor publik për trajtimin, zhvillimin dhe shtimin e sipërfaqes së pyjeve dhe volumit të tyre;

ç) hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit dhe monitorimin e pyjeve, studime e kërkime shkencore, si dhe për mbështetjen e bashkive si njësi të vetëqeverisjes vendore dhe pronarëve privatë;

d) organizimin e fushatave periodike për edukimin dhe ndërgjegjësimin publik për mbrojtjen dhe mirëqeverisjen e pyjeve.



KREU IV ORGANIZIMI I SEKTORIT TË PYJEVE

Neni 14

Institucionet qendrore përgjegjëse për pyjet

1. Ministria është institucioni më i lartë politikëbërës dhe rregullator, që garanton zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit, duke koordinuar partneritetin me sektorët dhe aktorët e tjerë dhe ekuilibruar interesat sektoriale.

2. Agjencia shtetërore përgjegjëse për pyjet është person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit, që ka si mision mirëqeverisjen e pyjeve në nivel kombëtar, ruajtjen dhe zhvillimin e tyre, përdorimin e qëndrueshëm dhe shumëfunksional të burimeve në fondin pyjor kombëtar, si pasuri natyrore me rëndësi kombëtare.

3. Agjencia përgjegjëse për zonat e mbrojtura është institucioni qendror shtetëror përgjegjës për zonat e mbrojtura, në varësi të ministrit, sipas legjislacionit të posaçëm për zonat e mbrojtura.

Neni 15

Përgjegjësitë e institucioneve qendrore për pyjet

1. Ministria, në përmbushje të rolit të saj, nëpërmjet strukturave përgjegjëse për pyjet në ministri ka këto përgjegjësi:

a) përcakton drejtësitë e politikave për pyjet, duke garantuar harmonizimin me prioritetet kombëtare dhe politikat e tjera sektoriale;

b) harton dhe monitoron zbatimin e programeve dhe të dokumenteve strategjike për zhvillimin, ruajtjen dhe administrimin e fondit pyjor kombëtar;

c) harton dhe përmirëson kuadrin ligjor rregullator në fushën e pyjeve, monitoron zbatimin dhe efektivitetin e tij, si dhe përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare për pyjet;

ç) planifikon financimin e sektorit bazuar në politikat dhe prioritetet e miratuara, duke garantuar shpërndarjen e drejtë dhe eficiente të fondeve;

d) miraton planet e mbarështimit për të gjitha format e pronësisë;

dh) certifikon ekspertë për ushtrimin e veprimtarisë së certifikimit të shërbimeve të

ekspertizës dhe profesionale në pyje e kullota, si dhe i shfuqizon ato sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Agjencia shtetërore përgjegjëse për pyjet ka këto përgjegjësi:

a) sigurimin e performancës në sektorin e pyjeve, vlerësimin e gjendjes së pyjeve dhe impaktit të sektorit përmes monitorimit të treguesve kyç dhe nivelit të realizimit të politikave, programeve dhe planeve në nivel kombëtar;

b) mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore përmes optimizimit të shfrytëzimit të tyre drejt përfitueshmërisë ekonomike në përputhje me prioritetet në përdorim e nevojat e vendit, si dhe me kriteret për mbarështimin e pyjeve;

c) propozimin të ministrit për vendosjen e normave, standardeve, çmimeve bazë dhe praktikave më të mira të unifikuara në fushën e pyjeve, me qëllim orientimin dhe eficiencën e strukturave dhe subjekteve që kanë të drejta dhe detyrime për fondin pyjor kombëtar, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) zbatimin e sistemeve të certifikimit të pyjeve të pranura në nivel ndërkombëtar;

d) garantimin e koordinimit, të bashkëveprimit dhe të angazhimit të strukturave përgjegjëse për pyjet, në nivel qendror dhe vendor, si dhe të aktorëve të tjerë (OJF, biznese, komunitete etj.), duke konsideruar edhe respektimin e barazisë gjinore;

dh) ngritjen dhe funksionimin e sistemit të integruar të informacionit për pyjet në nivel kombëtar, si dhe harmonizimin e kërkimit shkencor në fushën e pyjeve;

e) mbikëqyrjen e zbatimit të kërkesave ligjore dhe të dokumenteve planifikuese në pyje, si dhe këshillimin e ndërgjegjësimin e aktorëve në lidhje me detyrimet për pyjet;

ë) garantimin e funksionalitetit të sistemit të kontrollit dhe të inspektimit të veprimtarive që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar, duke ndërhyrë sipas përcaktimeve në këtë ligj.

Rregullat për organizimin dhe funksionimin e agjencisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

3. Agjencia përgjegjëse për zonat e mbrojtura garanton menaxhimin e qëndrueshëm, ruajtjen, rigjenerimin, përdorimin e fondit pyjor kombëtar nën administrim, kontrollin dhe inspektimin e tij, si dhe ushtron përgjegjësitë në përputhje me



dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionin e posaçëm për zonat e mbrojtura.

Neni 16

Strukturat vendore përgjegjëse për pyjet

1. Struktura përgjegjëse për qeverisjen e pyjeve në bashki është strukturë e specializuar në nivel vendor, me attribute menaxhuese, kontrolluese/inspektuese, teknike dhe këshillimore, që administron fondin pyjor kombëtar në pronësi, si dhe lëshon/pezullon/shfuqizon lejet për ushtrimin e aktivitetit për shfrytëzimin e fondit pyjor kombëtar për subjektet e interesuara.

2. Strukturat komunitare në fshat (kryetari i fshatit dhe kryesia e fshatit) kujdesen për përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve në fshat në përputhje me nevojat dhe politikat për zhvillimin e zonave rurale.

3. Bashkitë ngrenë strukturën përgjegjëse për pyjet brenda territorit të tyre, me personel me arsim profesional dhe të lartë pyjor, duke garantuar një raport të drejtë gjinor. Numri i punonjësve të strukturës përgjegjëse për pyjet përcaktohet në përpjesëtim me sipërfaqen e fondit pyjor si më poshtë:

a) një specialist pyjesh për 750 – 1000 ha për pyjet e larta;

b) një specialist pyjesh për 1500 – 2500 ha për pyjet e ulëta dhe shkurret.

4. Emërimi në detyrë i punonjësve të strukturës përgjegjëse për pyjet bëhet nga kryetari i bashkisë në përputhje me legjislacionin në fuqi, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil. Kriteret e përgjithshme të profesionalizmit për emërimin e punonjësve të strukturës përgjegjëse për pyjet hartohen nga agjencia shtetërore përgjegjëse për pyjet dhe miratohen nga ministri.

5. Inspektorët e strukturave kontrolluese /inspektuese të pyjeve në bashki, bazuar në natyrën e veçantë të funksionit që realizojnë dhe përgjegjësinë e përbashkët për përmbushjen e tij, bashkëpunojnë me strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe monitorimin pranë agjencisë shtetërore përgjegjëse për pyjet.

6. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit dhe procesit të inspektimit, inspektorët e strukturave kontrolluese/inspektuese të pyjeve në bashki raportojnë në përputhje me linjën dhe hierarkinë administrative përpara drejtuesit të

strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki, si dhe, kur kërkohet, pranë agjencisë dhe institucioneve të tjera të përcaktuara në këtë ligj.

7. Strukturat komunitare në fshat, nën koordinimin e bashkisë, bashkëpunojnë me strukturat vendore përgjegjëse për pyjet, me strukturat vendore të ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen dhe sigurinë e mjedisit për dhënien e informacioneve për veprimtaritë e paligjshme në mjediset pyjore, me shoqërinë civile dhe organizatat e ndryshme, duke angazhuar dhe përfshirë komunitetin për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor në pronësi të bashkisë.

8. Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, me programet dhe dokumentet strategjike për zhvillimin, ruajtjen dhe administrimin e fondit pyjor kombëtar, me vendim të kryetarit të bashkisë, strukturave komunitare mund t'u jepen detyra të caktuara për përdorimin e pyjeve, kujdesin dhe ruajtjen e tyre.

Neni 17

Përgjegjësitë e strukturave vendore përgjegjëse për pyjet

1. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki ka këto detyra:

a) përgjigjet për administrimin tërësor të fondit pyjor kombëtar, publik e privat, brenda kufijve administrativë të bashkisë;

b) ngre dhe mirëmban regjistrin e fondit pyjor kombëtar në bashki. Mbledh të dhëna për zhvillimin e pyjeve publike dhe private, përgjigjet për ruajtjen e ekuilibrit biologjik në fondin pyjor vendor dhe mban të dhëna të sëmundjeve, të dëmtuesve dhe të zjarreve në pyjet e bashkisë e ato private, brenda territorit administrativ të bashkisë;

c) harton, miraton, zbaton dhe kontrollon ecurinë sipas planeve operacionale, në përputhje me dokumentet e planifikimit strategjik dhe planet e mbarështimit, për fondin pyjor publik e privat, brenda territorit administrativ të bashkisë, duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse për mjedisin, si dhe administron të gjithë dokumentacionin përkatës;

ç) përgatit projektet për investimet në pyje, kontrollon dhe merr në dorëzim punimet e kryera në pyje, pavarësisht nga burimi i financimit, mbështet dhe miraton planifikimin e zbatimit e qeverisjes në pyjet private;



d) monitoron mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës në fondin pyjor publik;

dh) drejton dhe mbikëqyr punën për përmirësimin e zonave të gërryera dhe luftimin e erozionit, të rrëshqitjeve dhe ortekëve brenda territorit të bashkisë, si dhe luftën ndaj dëmtuesve dhe sëmundjeve;

e) siguron mbështetje teknike nëpërmjet këshillimit të pronarëve privatë dhe të përdoruesve të pyjeve publike dhe organizatave të tyre, si dhe organizon trajnime dhe ofron shërbim këshillimor për ta në përputhje e në respektim të barazisë gjinore;

ë) bashkëpunon për zhvillimin e veprimtarive kërkimore në pyje dhe mbikëqyr zhvillimin e florës e të faunës së egër dhe propozon mbrojtjen e llojeve të rrezikuara, të rralla ose në rrezik;

f) bashkëpunon me shoqërinë civile dhe organizatat e ngritura mbi baza ligjore me objekt të tyre “pyllin”, si dhe garanton gjithëpërfshirjen e popullsisë lokale për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor që ka në pronësi;

g) kontrollon dhe realizon proceset inspektuese për zbatimin e dispozitave ligjore dhe të akteve nënligjore në fuqi për pyjet, duke përfshirë veprimtaritë që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar nga subjektet private e publike, juridike e fizike, mbikëqyr zbatimin e kushteve të lejeve, licencave dhe detyrimeve kontraktuale nga ana e tyre, si dhe propozon tek institucioni përgjegjës pezullimin dhe shfuqizimin e tyre.

2. Strukturat komunitare në fshat (kryetari i fshatit dhe kryesia e fshatit) kujdesen për përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve në fshat në përputhje me nevojat dhe politikat për zhvillimin e zonave rurale, duke realizuar përgjegjësitë e mëposhtme:

a) kontribuojnë për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të fondit pyjor kombëtar në përdorim të komunitetit rural;

b) nxisin zhvillimin e agropylltarisë në pjesë/zona të përshtatshme të fondit pyjor kombëtar;

c) mundësojnë bashkëpunimin dhe koordinimin me strukturat përgjegjëse për pyjet në nivel qendror, rajonal dhe ato në bashki për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve të mbarështimit të pyjeve në afërsi të fshatit;

ç) ndihmojnë në ndërgjegjësimin e komunitetit rural për rëndësinë e ruajtjes së pyjeve dhe

ekuilibrave biologjikë në to, si dhe orientojnë përdorimin e pyjeve në përputhje me kërkesat ligjore dhe planet e mbarështimit;

d) sinjalojnë dhe bashkëpunojnë me strukturat kontrolluese dhe monitoruese për parandalimin dhe ndëshkimin e aktiviteteve të paligjshme që dëmtojnë pyjet.

Neni 18

Profesionistët e pyjeve

Në kuptim të këtij ligji, profesionistë të pyjeve janë:

a) punonjësit e institucioneve përgjegjëse për pyjet, në nivel qendror dhe vendor;

b) specialistët e institucioneve të arsimit profesional dhe të arsimit të lartë në fushën e pyjeve;

c) stafi teknik dhe profesional i institucioneve përgjegjëse për pyjet;

ç) ekspertët në fushën e pyjeve.

Neni 19

Përgjegjësitë e profesionistëve të pyjeve

1. Institucionet përgjegjëse për pyjet promovojnë rolin e profesionistëve të pyjeve dhe garantojnë mbrojtjen e rritjen/zhvillimin e tyre, kushte pune të përshtatshme, vlerësimin e drejtë dhe të paanshëm të performancës, si dhe rritjen në karrierë bazuar në parimin e meritokracisë.

2. Organizimi i strukturave përgjegjëse për pyjet, në nivel qendror dhe vendor, bëhet mbi bazën e parimit të profesionalizmit. Në pozicionet që mbulojnë funksione teknike apo ku kërkohen njohuri të specializuara për pyjet, stafi i punësuar duhet të zotërojë formimin përkatës profesional në degën e inxhinierisë së pyjeve ose degë të tjera të lidhura me pyjet dhe mjedisin ose të kenë diplomë të nivelit 4 ose 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në një nga drejtimet e profilit “pyje”, të ofruara në shkollat e arsimit të mesëm profesional.

3. Institucionet e arsimit profesional dhe të arsimit të lartë në fushën e pyjeve planifikojnë numrin e kuotave në degët përkatëse, me qëllim formimin e specialistëve të ardhshëm, në përputhje me kërkesat që vijnë nga institucionet publike përgjegjëse për qeverisjen e pyjeve, të përcaktuara



në këtë ligj, si dhe politikat qeverisëse për arsimin përkatës.

4. Stafit teknik dhe profesional i institucioneve përgjegjëse për pyjet u nënshtrohet programeve të zhvillimit/trajnitimit të vazhdueshëm. Agjencia realizon organizimin dhe koordinimin e aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë donatorët, me qëllim integrimin në një program të trajnimeve të parashikuara në kuadër të projekteve të ndryshme.

5. Ekspertët në fushën e pyjeve, përgjegjës për shërbimin e ekspertizës profesionale në pyje e kullota, kryejnë aktivitetin vetëm në rast kur janë të certifikuar. Rregullat, procedurat dhe kriteret për pajisjen me certifikatën e ekspertit miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Certifikata e ekspertit në fushën e pyjeve lëshohet nga ministri sipas formatit të miratuar prej tij.

Neni 20

Kërkimi shkencor në fondin pyjor kombëtar

1. Veprimtaritë kërkimore e shkencore në fushën e pyjeve kryhen nga institucione arsimore e shkencore, subjekte juridike e fizike, që përmbushin kushtet dhe kriteret, sipas legjislacionit të posaçëm në fushën kërkimore-shkencore, duke konsideruar edhe respektimin e barazisë gjinore. Ministria dhe bashkitë bashkëpunojnë me ministrinë përgjegjëse për arsimin, për planifikimin dhe financimin e punës kërkimore e shkencore në fondin pyjor kombëtar.

2. Institucionet arsimore e shkencore bashkërendojnë aktivitetin e tyre me institucionet publike në nivel qendror e vendor, me qëllim orientimin e punës së tyre drejt nevojave reale dhe prioriteteve të sektorit, sigurimin e konsulencave, oponencave dhe asistencës teknike, si dhe vënien në përdorim dhe aplikimit në praktikë të dijeve të akumuluar, të zbulimeve dhe rezultateve të punës akademike e kërkimore për përmirësimin e qeverisjes së pyjeve.

3. Institucionet arsimore, institucione të tjera dhe subjekte juridike e fizike kanë të drejtë të kërkojnë ngritjen e bazave eksperimentale dhe didaktike në fondin pyjor publik për zhvillimin e veprimtarive kërkimore e shkencore, praktikave mësimore të nxënësve e studentëve dhe kualifikimin e specialistëve të pyjeve, të cilat miratohen:

a) nga bashkia, për fondin pyjor në pronësi të saj;

b) nga agjencia përgjegjëse për zonat e mbrojtura, për sipërfaqet në zonat e mbrojtura.

4. Me propozim të ministrit, Këshilli i Ministrave miraton kriteret e ushtrimit, të miratimit dhe të monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në fondin pyjor kombëtar.

5. Grumbujt pyjorë me lloje me vlera të larta gjenetike, aktuale apo potenciale shpallen “burime gjenetike” me urdher të ministrit dhe ruhen “in-situ”.

6. Grumbujt e drurëve dhe të llojeve pyjore, të caktuara për konservim, germoplazmë, “in-situ” dhe “ex-situ”, për grumbullim, përpunim, shpërndarje dhe certifikim të materialit mbjellës administrohen nga bashkitë/agjencia përgjegjëse për zonat e mbrojtura.

Neni 21

Sistemi i integruar i informacionit në pyje

1. Sistemi i integruar i informacionit në pyje përbëhet nga të dhënat e mbledhura dhe të ruajtura në bazën shtetërore të të dhënave për pyjet, nga teknologjia, pajisjet, rrjetet dhe aplikacionet, që mundësojnë shkëmbimin e këtyre të dhënave dhe informacionit mes institucioneve përgjegjëse për pyjet në nivel qendror dhe vendor.

2. Baza shtetërore e të dhënave organizon dhe integron të dhënat dhe informacionin që përmban inventari kombëtar i pyjeve, planet e mbarështimit, regjistri kombëtar i fondit pyjor, si dhe informacionin për monitorimin e fondit pyjor kombëtar, duke ofruar një pasqyrë të hollësishme e të detajuar të treguesve pyjorë, për të garantuar menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, duke përfshirë edhe të dhënat që kanë referencë gjeohapësinore.

3. Agjencia projekton, ndërton, mirëmban dhe përditëson sistemin e integruar të informacionit (që përmbledh sistemet ALFIS në sektorin e pyjeve, duke garantuar aksesin dhe shkëmbimin e të dhënave sipas ligjit dhe siguruar ndërveprimin me bashkitë/agjencitë përgjegjëse të zonave të mbrojtura për marrjen e informacionit vendor në kohë reale, nën orientimin e ASIG-ut (Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor).

4. Agjencia monitoron performancën e qeverisjes së pyjeve bazuar në treguesin e



dinamikës së produktivitetit të tokës dhe jep rekomandimet e duhura për përmirësimin e gjendjes të strukturat përgjegjëse.

Neni 22

Infrastruktura në fondin pyjor kombëtar

1. Bashkitë dhe agjencia përgjegjëse për zonat e mbrojtura janë përgjegjëse për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës në fondin pyjor kombëtar, që kanë nën administrim, në përputhje me dokumentet planifikuese në pyje. Për fondin pyjor privat kjo infrastrukturë ndërtohet nga pronarët.

2. Agjencia, në bashkëpunim me bashkitë/agjencinë përgjegjëse për zonat e mbrojtura, mbikëqyr ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës në pyje, si dhe ofron mbështetje teknike dhe financiare në rastet kur investimet në infrastrukturë realizohen me financimet e buxhetit të shtetit.

3. Personat juridikë ose fizikë, që kanë marrë pyje në përdorim ose shfrytëzim sipas legjislacionit në fuqi, ndërtojnë, riparojnë dhe mirëmbajnë infrastrukturën pyjore me mjetet e tyre financiare. Në rastin kur ndërtojnë rrugë të reja, shpenzimet reflektohen në tarifat e reduktuara të lëndës drusore.

4. Bazuar në kërkesat për mbrojtjen e pyjeve dhe kryerjen e shërbimeve në to, strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki dhe agjencia përgjegjëse për zonat e mbrojtura mund të kufizojnë, bllokojnë ose vendosin tarifa për qarkullimin në rrugët pyjore.

5. Në raste zjarresh, katastrofash natyrore ose manovrash ushtarake, lejohet, pa asnjë kufizim, përdorimi i infrastrukturës rrugore në fondin pyjor kombëtar.

6. Asetet, instalimet dhe rrjetet, të cilat janë pjesë e infrastrukturës publike kombëtare dhe lokale, por shtrihen në sipërfaqet e fondit pyjor kombëtar, projektohen, ndërtohen dhe mirëmbahen nga entet dhe institucionet përgjegjëse në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe të kuadrit ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, duke respektuar dokumentet strategjike në sektorin e pyjeve dhe planet e mbarështimit të ekonomive pyjore, me qëllim mbrojtjen dhe moscenimin e pyllit dhe të mjedisit.

7. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregulla të hollësishme për zbatimin e pikës 3 të këtij neni.

KREU V

PËR FITIMET NGA SHFRYTËZIMI I FONDIT PYJOR KOMBËTAR

Neni 23

Kategoritë e përfitimeve dhe rregullat për shfrytëzimin e fondit pyjor kombëtar

1. Përfitimet nga shfrytëzimi i fondit pyjor kombëtar kategorizohen si më poshtë:

a) përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve në ekosistem që pylli mundëson;

b) përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari të ndryshme, që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar;

c) përfitimet nga prodhimi, shfrytëzimi dhe shitja e prodhimeve jodrusore nga pylli;

ç) përfitimet nga prodhimi, shfrytëzimi dhe shitja e materialit drusor.

Në dhënien e të drejtave për të përfituar nga shfrytëzimi i fondit pyjor kombëtar mbahet në konsideratë rëndësia dhe interesi publik për pyjet si pasuri kombëtare, që prevalon mbi çdo interes tjetër që mund të ndërthuret me fondin pyjor kombëtar.

2. Personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtë të shfrytëzojnë fondin pyjor kombëtar vetëm kur kanë dalë fitues në procedurat e konkurrimit publik dhe kur lidhin kontratën me bashkitë/ agjencinë përgjegjëse për zonat e mbrojtura sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) kërkesat, që duhet të plotësojnë subjektet për pjesëmarrje në konkurrimin publik, përcaktohen me udhëzim të ministrit;

b) të drejtat, që sigurohen nga kontrata për shfrytëzimin e fondit pyjor kombëtar, nuk mund të transferohen;

c) subjektet, që kanë lidhur kontratën, mund të ndërtojnë ose të vendosin instalime të përkohshme, sipas skemave teknologjike të miratuara nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki dhe agjencia përgjegjëse për zonat e mbrojtura, duke plotësuar kërkesat dhe standardet e përshtatshmërisë për personat me aftësi të kufizuara aty ku është e mundur;

ç) kur subjekti privat i specializuar kërkon të marrë sipërfaqe të mëdha nga fondi pyjor



kombëtar për afate të gjata kohore për të rehabilituar pyjet (përfshirë pyllëzimet me drurë pyjorë në sipërfaqet e degraduara dhe tokat e abandonuara), kërkesa shqyrtohet në mbështetje të legjislacionit për koncesionet dhe partneritetin publik privat.

3. Veprimtaritë e shfrytëzimit në fondin pyjor kombëtar, përveçse kur kryhen nga strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki, si dhe nga banorët apo pronarët për nevojat e tyre, sipas këtij ligji, mund të realizohen vetëm nga individë apo subjekte të licencuara sipas ligjit në përputhje me procedurat e miratuara nga Këshilli i Ministrave.

4. Procedurat e unifikuara në nivel kombëtar, që do të ndiqen për shfrytëzimin e pyjeve nga banorët për nevojat e tyre (si mënyra e likuidimit të tarifave, procesi i damkimit, lidhja e kontratës, dorëzimi dhe kolaudimi i parcelave etj.), përgatiten nga agjencia shtetërore përgjegjëse për pyjet në konsultim me bashkitë dhe miratohen me urdhër të ministrit.

5. Strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki, nën bashkërendimin e agjencisë shtetërore përgjegjëse për pyjet, në lidhje me elementet e marketingut, sipas përkufizimit në këtë ligj:

a) ndërtojnë bazën e të dhënave të prodhimeve drusore dhe jodrusore nga pylli, të përfituara nga shfrytëzimi dhe të shitura, me vendndodhjen e tyre, si dhe të shërbimeve të ofruara në pyje së bashku me tarifën, çmimet apo vlerat përkatëse;

b) monitorojnë në vijimësi kërkesë-ofertën në treg dhe çmimet e produkteve drusore të papërpunuara, gjysmë të përpunuara dhe të përpunuara të produkteve jodrusore nga pylli e shërbimeve të ndryshme në pyje dhe i reflektojnë ato në bazën e të dhënave;

c) promovojnë vlerat e shumëfishta të fondit pyjor kombëtar, nevojën për mbrojtjen dhe zhvillimin e tij nëpërmjet mënyrave dhe mjeteve të ndryshme të publikimit e të informimit.

Neni 24

Përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve në ekosistem

1. Shërbimet në ekosistem janë përfitimet që sigurohen nga funksionet natyrore të pyjeve dhe punimet e kryera në to, ku përfshihen kategoritë e shërbimeve sipas përkufizimit në këtë ligj.

2. Strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki dhe agjencia përgjegjëse për zonat e mbrojtura

vlerësojnë shërbimet e ekosistemit, që mundësojnë pyjet nën përgjegjësinë e tyre, si përfitimet që njerëzit marrin prej pyjeve.

3. Pyjet janë edhe objekt i përthithjes së karbonit, që llogaritet dhe tregtohet sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në Protokollin e Kiotos, ku:

a) kuotat e karbonit, në procesin e sekuestrimit të tij, u përkasin pronarëve, sipas pronësisë që kanë mbi fondin pyjor;

b) ministria është institucioni përgjegjës për zbatimin e dispozitave të Protokollit të Kiotos dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

4. Rregullat për përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, kompensimi dhe pagesat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Neni 25

Përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar

1. Pjesë të fondit pyjor publik jepen në shfrytëzim/përdorim për zhvillimin e veprimtarive për:

a) qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore, turistike, sportive dhe kulturore;

b) mbarështimin e florës dhe të faunës së egër, kultivimin dhe grumbullimin e bimëve të ndryshme, zhvillimin e agropylltarisë, akuakulturës, kullotjen e blegtorisë, kositjen e barit dhe zhvillimin e gjuetisë;

c) shtrimin e rrjeteve/linjave, tubacioneve dhe ndërtime infrastrukturore të tjera të përkohshme ose të përhershme;

ç) nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte në karrierë, kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit të mineraleve, hidrokarbureve dhe të ujit.

2. Strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki identifikojnë dhe shpallin listën e vendeve ose të shesheve të fondit pyjor publik, ku mund të ushtrohen këto veprimtari të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

3. Dhënia në shfrytëzim/përdorim e pjesëve të fondit pyjor kombëtar për veprimtari të përmendura në pikën 1 të këtij neni, bëhet në bazë të kontratave të nënshkruara nga kryetari i bashkisë/organi përgjegjës për zonat e mbrojtura



kur përfshihet në këto zona. Kontratat përfundojnë në çastin kur KKT-ja miraton tjetër zhvillim për sipërfaqen e fondit pyjor kombëtar, objekt kontrate. Rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për këto veprimtari caktohen me udhëzim të ministrit.

4. Çmimet dhe tarifat për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për pyjet dhe ministrit përgjegjës për financat. Pronarët privatë, për veprimtaritë që zhvillohen në fondin pyjor në pronësi të tyre, kanë të drejtë të përdorin çmime dhe tarifa të vendosura në marrëveshje me subjektet e interesuara.

5. Subjektet që marrin në shfrytëzim/ përdorim pjesë të fondit pyjor kombëtar, duhet të jenë të licencuara për ushtrimin e aktivitetit në përputhje me legjislacionin përkatës, si dhe kanë detyrimin për të depozituar planin e rehabilitimit që do të zbatohet sipas planit/grafikut të shfrytëzimit të miratuar nga ministria përgjegjëse për aktivitetin në sipërfaqet respektive dhe rehabilitimin përfundimtar në mbyllje të aktivitetit në zonën përkatëse.

6. Kriteret, kushtet, mënyra dhe realizimi i rehabilitimit bëhet bazuar në udhëzimin e ministrit në bashkërendim me ministrinë përgjegjëse për aktivitetin e miratuar.

Neni 26

Përfitimet nga shfrytëzimi i produkteve jodrusore nga pylli

1. Shfrytëzimi i prodhimeve jodrusore nga pylli lejohet në fondin pyjor kombëtar për qëllime të përfitimit ekonomik, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin e posaçëm për bimët mjekësore, eterovajore dhe tanifere natyrore dhe në mbështetje të kriterëve dhe kontigjentëve të caktuar nga ministria, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Vjelja e prodhimeve jodrusore në pyje kryhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore, duke mos cenuar mbrojtjen e tokës dhe të elementeve klimatike, ekologjike e shoqërore. Rregullat dhe kriteret caktohen me manual të miratuar me urdhër të ministrit.

3. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki dhe ajo për zonat e mbrojtura vlerëson dhe planifikon mundësinë e shfrytëzimit të prodhimeve jodrusore nga pylli, brenda mundësisë vjetore të shfrytëzimit të fondit pyjor kombëtar, bazuar në planet e mbarështimit dhe mbështetur në bazën e të dhënave, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Grumbullimi i prodhimeve jodrusore pyjore e nënprodukteve të fondit pyjor kombëtar mund të kryhet nga persona fizikë e juridikë, të pajisur me leje sipas legjislacionit në fuqi për licencat, lejet dhe autorizimet, kategoria III.4, dhe individët, pasi të kenë marrë miratimin nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki ose në zonat e mbrojtura, si dhe të kenë depozituar planin e rehabilitimit që do të zbatohet në përfundim të aktivitetit në zonën përkatëse. Përfundimisht, për individët kërkohet vetëm miratimi nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki ose në zonat e mbrojtura.

5. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, mbi bazën e planifikimit dhe të lejeve që lëshon për subjektet grumbulluese, i pajis ato edhe me certifikatën e origjinës.

6. Subjektet që veprojnë në tregtinë e prodhimeve jodrusore pyjore janë përgjegjëse për promovimin e rëndësisë dhe përfitimeve të prodhimeve jodrusore pyjore, për hartimin dhe përhapjen e informacionit mbi to, kryerjen e trajnimeve dhe udhëzimin e personave/komuniteteve që angazhohen në mbledhjen dhe përpunimin e tyre, duke garantuar shfrytëzimin brenda mundësive prodhuese e biologjike dhe përputhshmërinë me teknikat që mundësojnë rigjenerimin e tyre, në funksion edhe të forcimit të ekonomive rurale dhe të përmirësimit të kushteve të jetesës në fshat.

7. Të gjitha produktet pyjore jodrusore (përfshirë bimët mjekësore, eterovajore dhe tanifere natyrore) transportohen dhe shiten pasi të jenë pajisur me certifikatë origjine.

Neni 27

Përfitimet nga shfrytëzimi i produkteve drusore

1. Shfrytëzimi i materialit drusor lejohet në fondin pyjor kombëtar për qëllime të përfitimit ekonomik dhe vetëm nëpërmjet kryerjes së punimeve të parashikuara në planet e mbarështimit



duke u realizuar sipas përcaktimeve në këtë ligj. Në trajtimin dhe shfrytëzimin e fondit pyjor, përdorimi i standardeve për prerjet vjetore të lejueshme, ciklet e prerjeve, teknikat e shfrytëzimit dhe infrastruktura janë të detyrueshme.

2. Vëllimi i materialit drusor, që do të shfrytëzohet çdo vit, planifikohet brenda mundësisë vjetore të shfrytëzimit, bazuar në planet e mbarështimit. Pjesë e këtij vëllimi është edhe vëllimi i materialit drusor me vlerë ekonomike, i planifikuar nga prerjet kulturore, si edhe nga dëmtimet si rezultat i katastrofave natyrore ose zjarret. Në lidhje me këtë vëllim:

a) planifikimi i mundësisë vjetore të shfrytëzimit për fondin pyjor, publik dhe atë privat hartohet nga struktura përgjegjëse për pyjet pranë bashkisë;

b) ministri, brenda muajit dhjetor të çdo viti, miraton me urdhër mundësinë vjetore të shfrytëzimit për pyjet në përputhje me të dhënat e planit operacional vjetor, bazuar në propozimin e kryetarit të bashkisë;

c) struktura administrative përgjegjëse për pyjet monitoron, periodikisht, prodhimet drusore të realizuara nga subjektet që shfrytëzojnë pyjet, bën rakordimet për përputhshmërinë e vëllimit të prodhimeve me vëllimin e lëndës së kontraktuar.

3. Shitja e lëndës drusore nga bashkitë bëhet me ankand, sipas legjislacionit në fuqi, në dy mënyra: me fuqi lëndore në këmbë (të paprerë), ose me asortimente, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në pikat 3 e 4, të nenit 25, të këtij ligji, ku shitja bëhet sipas tarifave bazë të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Rregullat për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin (rastet e lejuara), importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore, si dhe kategorizimi i rrugëve autopsyjore, përdorimi dhe standardet teknike të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

5. Pronarët privatë kanë të drejtë ta shesin materialin drusor dhe jodrusor në fondin pyjor në pronësi të tyre pa ankand dhe sipas çmimeve apo tarifave të vendosura në marrëveshje me subjektet e interesuara, duke respektuar rregullat e vendimit të Këshillit të Ministrave, referuar në pikën e mësipërme, për sa i takon trajtimin, shfrytëzimin dhe transportin të materialit drusor dhe prodhimeve jodrusore pyjore. Çmimet dhe tarifat për prodhimet drusore dhe jodrusore në fondin pyjor

kombëtar miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për pyjet dhe të ministrit përgjegjës për financat.

6. Shfrytëzimi i prodhimit drusor mund të kryhet nga persona fizikë e juridikë, të pajisur me leje sipas legjislacionit në fuqi për licencat, lejet dhe autorizimet, kategoria III.4, individët apo njësitë/ekipet e specializuara të bashkisë, pasi të jetë hartuar dhe miratuar projekti teknologjik i shfrytëzimit në përputhje me planin e mbarështimit. Subjektet që zotërojnë të drejtën e shfrytëzimit të prodhimeve drusore janë përgjegjëse për trajnimin dhe udhëzimin e stafit, për teknikat dhe metodologjitë e shfrytëzimit të materialit drusor, që garantojnë ruajtjen dhe ripërtëritjen e pyllit, në përputhje me kërkesat ligjore.

7. Materiali drusor i papërpunuar, si dhe prodhimet e tjera pyjore e jopyjore transportohen nga pikat e grumbullimit dhe qendrat e përpunimit deri në destinacionin përfundimtar, të shoqëruara me vërtetim transporti, të lëshuar nga struktura përkatëse e shërbimit pyjor në bashki ose nga pronari privat që vërteton se prodhimi është në përputhje me ligjin. Modeli i vërtetimit të transportit miratohet me urdhër të ministrit.

8. Subjektet që veprojnë në tregtinë e lëndës drusore dhe të prodhimeve jodrusore pyjore zbatojnë sistemin “kujdesi i duhur” për të parandaluar tregtimin e tyre nëse janë prerë apo grumbulluar në mënyrë të paligjshme. Për zbatimin e sistemit “kujdesi i duhur”:

a) shitësi dhe blerësi i lëndës drusore, të papërpunuar e të përpunuar, dhe i prodhimeve jodrusore pyjore janë të detyruar të vërtetojnë origjinën e ligjshme të tyre nëpërmjet kontratave dhe dokumentacionit tjetër plotësues ligjor, përfshirë detyrimisht certifikatën e origjinës;

b) rregullat dhe procedurat për zbatimin e sistemit “kujdesi i duhur” miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

9. Certifikimi i cilësisë së produkteve, përfshirë prodhimet drusore dhe ato jodrusore nga pylli, bëhet nga subjekte të akredituara sipas legjislacionit në fuqi, ku:

a) për certifikimin e cilësisë së produkteve pyjore lidhen marrëveshje teknike midis pronarëve të pyjeve dhe subjekteve të akredituara;

b) sistemet e certifikimit, karakteristikat dhe kërkesat e organeve kombëtare për certifikimin



miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

Neni 28

Shitja e lëndës së drurit dhe produkteve të tij në tregun e BE-së

1. Subjektet që veprojnë në tregtinë e lëndës drusore duhet të ushtrojnë “kujdesin e duhur” kur ato fusin në tregun e BE-së drurin ose produktet e drurit, vendas ose të importuar.

2. Pranohen si të ligjshme druri dhe produktet e drurit, të shoqëruara me licencë sipas FLEGT-it ose Konventës për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara (CITES).

3. Skema e licencimit FLEGT përbën një grupim rregullash dhe procedurash për importin e disa produkteve të drurit, që zbatohet nëpërmjet marrëveshjeve të partneritetit me shtetet që prodhojnë dru/lëndë druri.

4. Me propozimin e ministrit, Këshilli i Ministrave përcakton institucionet dhe autoritetet përkatëse, si dhe miraton rregullat dhe procedurat për zbatimin e rregulloreve FLEGT dhe EUTR, përfshi zbatimin e çdo rregullimi tjetër që bëhet i detyrueshëm për shtetin shqiptar në të ardhmen.

KREU VI

TRAJTIMI DHE SHËRBIMET NDAJ PYJEVE

Neni 29

Elementet e shërbimit ndaj fondit pyjor kombëtar

1. Shërbimi ndaj fondit pyjor kombëtar ka si qëllim mbrojtjen, trajtimin dhe kryerjen e punimeve silvikulturore e të punimeve të tjera në fondin pyjor, të cilat mundësojnë sigurimin e funksioneve ekologjike dhe shoqërore, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës pyjore, vjeljen e prodhimeve pyjore, duke siguruar vazhdimësinë e prodhimeve pyjore, të burimeve të tjera dhe të gjeneratës së re të masivit pyjor.

2. Shërbimi ndaj fondit pyjor kombëtar përfshin të gjitha veprimtaritë, masat silvikulturore dhe punimet që kryhen nga strukturat përgjegjëse për pyjet dhe/apo subjektet që kanë fituar të drejta ose ushtrojnë veprimtari mbi të, që lidhen me mbrojtjen e fondit pyjor kombëtar nga dëmtimet e natyrave dhe origjinave të ndryshme, kryerjen e

mirëmbajtjes së fondit pyjor, realizimin e proceseve të prerjeve/vjeljes së prodhimeve pyjore, si dhe ripërtëritjen e fondit pyjor kombëtar.

3. Proceset kryesore të punës për garantimin e shërbimeve ndaj fondit pyjor kombëtar përfshijnë proceset e planifikimit, të zbatimit, të kontrollit, të certifikimit të punës, që duhet të kryhet sipas funksioneve të mbrojtjes, të mirëmbajtjes, të prerjeve, të rigjenerimit të fondit pyjor kombëtar.

4. Trajtimi i pyjeve bazohet në masat dhe rekomandimet e planifikuara në planet e mbarështimit nëpërmjet planeve operacionale vjetore, të cilat zbatohen nga strukturat që administrojnë pyjet, pronarët privatë, si dhe nga të gjithë personat, juridikë e fizikë, që zhvillojnë veprimtari në fondin pyjor kombëtar.

Neni 30

Mbrojtja e fondit pyjor kombëtar

1. Mbrojtja e pyjeve përfshin masat parandaluese, vëzhgimin e situatës në pyje dhe evidentimin e dëmeve apo sinjalizimin e pranisë së faktorëve dëmtues, rikuperimin e dëmeve dhe rehabilitimin e pjesëve të dëmtuara si pasojë e faktorëve dhe fenomeneve, që cenojnë dhe dëmtojnë fondin pyjor kombëtar, të tilla si:

a) prerjet ose kullotja pa leje, dëmtimi i fondit pyjor kombëtar (përfshirë infrastrukturën pyjore dhe veprat ujore), sëmundjet dhe insektet, zjarret, shkatërrimi, pushtimi apo tjetërsimi;

b) lëndët e gazta, të lëngëta, të ngurta, radioaktive, lëndë dhe mbetje të rrezikshme, që krijohen ose shkarkohen nga objekte a veprimtari industriale, bujqësore, komunale, tregtare, shoqërore e kulturore, ushtarake, të transportit;

c) çdo veprimtari që cenon ekuilibrin e sistemeve ekologjike, natyrore, ose dëmton të mirat materiale dhe vlerat kulturore e historike, e realizuar nga cilido institucion shtetëror, qendror apo vendor, personat fizikë a juridikë, vendas a të huaj.

2. Mbrojtja e fondit pyjor kombëtar, pavarësisht nga forma e pronësisë, është detyrë e përhershme e strukturave përgjegjëse për pyjet në nivel qendror dhe vendor, e pronarëve privatë, e subjekteve që kryejnë veprimtari në këtë fond dhe, sipas rastit, edhe e strukturave të tjera shtetërore të ngarkuara nga ligje të tjera.



3. Ndalohet ndezja e zjarreve në fondin pyjor kombëtar, publik apo privat, në tokat e tjera në afërsi të tyre, si dhe çdo veprim tjetër që përbën burim ose shkak për përhapjen e pakontrolluar të tyre.

4. Për parandalimin e zjarreve në fondin pyjor kombëtar:

a) strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki/zona të mbrojtura, si dhe pronarët privatë organizojnë sistemin e vrojtimit-sinjalizimit duke zbatuar të gjitha detyrimet sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile dhe për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;

b) struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, si dhe pronarët privatë, çdo vit hartojnë planin për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve, për sipërfaqen e fondit pyjor kombëtar në territorin e tyre, ku përfshihen mjetet në dispozicion, si dhe numri i personave të organizuar në njësitë e posaçme për këtë qëllim, duke koordinuar dhe zbatuar të gjitha përcaktimet e ligjit përkatës për mbrojtjen civile, vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe planin vendor për emergjencat civile;

c) plani për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor kombëtar miratohet nga këshilli bashkiak brenda muajit mars të çdo viti. Bashkitë koordinojnë këtë plan me detyrimet e ligjit përkatës për mbrojtjen civile, për të siguruar funksionimin e sistemit të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në territorin e tyre. Subjektet, që ushtrojnë veprimtari në fondin pyjor kombëtar, detyrohen sipas ligjit përkatës për mbrojtjen civile të garantojnë mbrojtjen nga zjarret në këto sipërfaqe, duke hartuar/përditësuar planet për mbrojtjen e tyre nga zjarret, të harmonizuara me planet e jashtme për emergjencat civile të bashkisë dhe prefekturës, si edhe detyrimin për rregulloret e brendshme të tyre;

ç) struktura përgjegjëse për pyjet në bashki organizon çdo vit fushata informimi, sensibilizimi dhe trajnimi për parandalimin e zjarreve në pyje. Këto fushata organizohen në nivel kombëtar edhe nga ministria dhe agjencia.

5. Për shuarjen e zjarreve në pyje:

a) njësitë e vetëqeverisjes vendore, komunitetet lokale dhe pronarët privatë ngrenë njësi të posaçme dhe bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me strukturat e tjera shtetërore sipas detyrimeve të

përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, përdoruesit e pyjeve përmes përfaqësuesve të tyre lokalë dhe pronarët privatë mbajnë të dhëna statistikore për zjarret në pyjet brenda territoreve të tyre dhe raportojnë pranë agjencisë shtetërore përgjegjëse për pyjet;

b) shpenzimet për shuarjen e zjarreve përballohen nga struktura ose subjekti që ka në pronësi pyllin dhe nga buxheti i shtetit në rastin e një prone me rëndësi kombëtare, historike, kulturore, arkeologjike, ekologjike etj.

6. Për masat e mbrojtjes së pyjeve nga rreziku i zjarrit zbatohen parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

7. Në rast konstatimi të pranisë së sëmundjeve e dëmtuesve ose dëmtimit të pyjeve nga shkaqe të tjera:

a) të gjitha subjektet që zhvillojnë veprimtari në fondin pyjor kombëtar, duhet të njoftojnë menjëherë strukturën përgjegjëse për pyjet dhe agjencinë;

b) strukturat përgjegjëse për pyjet, kur vërejnë se bimët dhe prodhimet pyjore janë të infektuara nga parazitë karantinorë dhe janë kryer shkelje të kuadrit ligjor në fuqi, bëjnë menjëherë bllokimin dhe njoftojnë jo vetëm pronarin ose përdoruesin, por edhe eprorët për arsyt e bllokimit;

c) shpenzimet e luftimit të sëmundjeve, dëmtuesve dhe insekteve në fondin pyjor kombëtar, në rastet e dëmtimeve masive, përballohen nga buxheti i shtetit.

8. Për mbrojtjen e fondit pyjor kombëtar ndalohet kullotja:

a) në zonat e mbrojtura, me përjashtim të rasteve kur ligji për zonat e mbrojtura lejon kullotjen dhe kalimin e kafshëve në këto zona;

b) në pyllëzimet e reja dhe në sipërfaqet me pyje të ulëta të ricunguara;

c) në grumbujt pyjorë që kanë arritur moshën e pjekurisë, ku pritët të arrihet ripërtëritja natyrale;

ç) në pyjet e shfrytëzuara ose në shfrytëzim e sipër deri sa të jetë bërë ripërtëritja natyrale e tyre.

9. Kriteret dhe rregullat për kullotjen në pyje përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 31

Përmirësimi i fondit pyjor kombëtar

1. Strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki hartojnë planet e përmirësimit të fondit pyjor



kombëtar që kanë nën administrim, ku planifikohen të gjitha ndërhyrjet dhe shërbimet për parandalimin e degradimit të fondit pyjor kombëtar dhe rehabilitimin e tij.

2. Për atë sa kushtet dhe mundësitë lejojnë, strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki i realizojnë shërbimet ndaj pyjeve në përputhje me parimin e eficiencës ekonomike në kryerjen e ndërhyrjeve përmirësuese.

3. Punimet mbrojtëse dhe ripërtëritëse në fondin pyjor kombëtar kryhen për të parandaluar ose kufizuar veprimet shkatërruese në pyll. Masa për kryerjen e punimeve mbrojtëse e ripërtëritëse ndërmarrin edhe pronarët për drurët pyjorë që ndodhen në tokat pyjore, në tokat bujqësore në afërsi të pyllit, si dhe për drurët që ndodhen jashtë fondit pyjor kombëtar.

4. Rritja e prodhimtarisë së fondit pyjor kombëtar nëpërmjet ripërtëritjes së pyjeve të shfrytëzuar, përmirësimit të pyjeve ekzistuese, zbatimit të punimeve sanitare dhe të mirëmbajtjes në përputhje me funksionin e pyjeve dhe nevojat ekonomike, si dhe shtimi i sipërfaqes së fondit pyjor kombëtar nëpërmjet pyllëzimit të tokave bujqësore, të braktisura e të pandara, të vendeve të zhveshura e të gërryer, të djegura, të tokave ranore e zhavorrishte e të tjera të kësaj kategorie është detyrë e strukturave përgjegjëse për pyjet dhe e përdoruesve të këtyre tokave.

5. Mirëmbajtja e infrastrukturës së fondit pyjor kombëtar realizohet nga strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki/zona të mbrojtura, në bashkëpunim me strukturat e tjera në bashki, që janë përgjegjëse për punët dhe infrastrukturën publike.

6. Subjektet që kanë të drejta mbi pyjet, që administrojnë ose shfrytëzojnë pjesë të fondit pyjor kombëtar dhe prodhimet e tij, janë përgjegjëse për ngritjen dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës përkatëse në shërbim të veprimtarisë që realizojnë në përputhje me miratimet dhe lejen e strukturave përgjegjëse për pyjet në bashki.

7. Sistemimet malore (gardhet/pritat) ndërtohen për frenimin e dukurisë së gërryerjes në sipërfaqet e fondit pyjor kombëtar, ku kjo dukuri është e pranishme, dhe, sipas nevojave dhe kushteve konkrete, shoqërohen me pyllëzimin e shpateve të ujëmbledhësve, përrenjeve dhe përroskave.

8. Rregullat, kriteret teknike dhe metodologjia e posaçme për shërbimet që kryhen në fondin pyjor kombëtar përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 32

Prerjet në fondin pyjor kombëtar

1. Prerjet në ngastra/nënngastra, për shkak të ndërhyrjeve dhe trajtimeve silvikulturore në jetën e pyllit apo vjeljes së materialit drusor dhe prodhimeve të tjera, lejohen:

a) vetëm në moshën e shfrytëzueshmërisë dhe kur pylli ka arritur fazën e pjekurisë;

b) kur realizohen nën kontrollin e strukturave përgjegjëse për pyjet dhe vetëm kur kërkohet teknikisht sipas projekteve përkatëse në rastet:

i. e prerjeve farore, dritësuese dhe përfundimtare, mbështetur në rekomandimet e planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore;

ii. e prerjeve në pyjet e dëmtuara nga katastrofat natyrore apo si pasojë e rënies së zjarreve;

c) kur prerja e drurëve në fondin pyjor kombëtar bëhet pas shënimit të tyre me damkë. E drejta e damkimit, administrimi dhe mënyra e përdorimit të çekiçdamkës përcaktohen me udhëzim të ministrit;

ç) kur subjektet që kryejnë prerje shfrytëzuese në fondin pyjor publik dhe privat shënojnë me bojë të paheqshme dhe vendosin etiketa në prodhimet e tyre sipas kriterëve të vendosura me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit;

d) kur prerjet shfrytëzuese në fondin pyjor publik e privat organizohen në bazë të vitit pyjor, i cili fillon në datën 1 tetor dhe përfundon në datën 30 shtator të vitit pasardhës;

dh) në sipërfaqet me filizëri të zhvilluar mbi lartësinë optimale, ku prerjet shfrytëzuese lejohen edhe në periudhën e vegetacionit, duke respektuar kriteret teknike të vendosura me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

2. Projektet e punimeve kulture, projektet e pyllëzimit dhe të rehabilitimit të fondit pyjor mbështeten në rekomandimet e planit të mbarështimit dhe miratohen nga agjencia shtetërore përgjegjëse për pyjet.

3. Në fondin pyjor kombëtar:

a) ndalohet shndërrimi i pyjeve të larta në cungsishte;

b) ndalohet prerja rrah e pyjeve të larta, me përjashtim të ndërhyrjeve të nevojshme për



mbrojtjen fitosanitare ose për arsye të tjera me interes publik;

c) ndalohet shfrytëzimi i pyjeve cungishte dhe prerja rrah në periudhën e vegetacionit, si dhe kur nuk sigurohet mbrojtja hidrogeologjike e territorit, ruajtja e burimeve ujore, mbrojtja e peizazhit dhe mjedisit, turizmi dhe rekreacioni;

ç) ndalohet prerja rrah në pyjet me funksion mbrojtës;

d) ndalohen prerjet për shfrytëzimin e pyjeve:

i. në kufijtë e sipërm të vegetacionit pyjor;

ii. mbi dhe nën rrugët kombëtare deri 150 metër linear;

iii. përreth qendrave të banuara dhe objekteve të rëndësishme;

iv. përgjatë rrjedhave ujore.

4. Krijimi i rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë), ruajtja dhe trajtimi i pyjeve të virgjra ose pothuajse të virgjra, si dhe kalimi i tyre në konservim të plotë bëhen në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Neni 33

Rigjenerimi i fondit pyjor kombëtar

1. Në trajtimin e pyjeve, zhvillimi dhe ripërtëritja natyrore e tyre sigurohet edhe nëpërmjet rigjenerimit nga operacionet silvikulturore si më poshtë:

a) sipërfaqet e pyjeve të larta përshkohen me prerje kulturore sipas fazës së zhvillimit në të cilën gjenden dhe të kërkesave të silvikulturës;

b) strukturat përgjegjëse për pyjet ndërmarrin masat dhe garantojnë kushtet për rigjenerimin natyror të pyjeve në përputhje me ciklet e tyre natyrore dhe karakteristikat e tjera të ekosistemit pyjor.

2. Rehabilitimi i ekosistemeve pyjore, i tokave pyjore të degraduara e të braktisura, i peizazhit pyjor, i habitateve të florës e faunës së egër kryhet nën drejtimin e strukturave përgjegjëse për pyjet sipas këtij ligji, nëpërmjet mënyrave të mëposhtme:

a) rehabilitimi i terreneve të degraduara kryhet nëpërmjet nxitjes dhe mbështetjes së pyllëzimeve, ripyllëzimeve, agropylltarisë në pronat publike e private;

b) zgjedhja e materialit mbjellës, fara e fidanë, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për

mbrojtjen e biodiversitetit dhe për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor.

3. Ripyllëzimet kryhen në sipërfaqet pyjore të dëmtuara nga shkaqe të ndryshme dhe ku nuk është siguruar ripërtëritja në rrugë natyrore, në sipërfaqet ku filizëria e instaluar është djegur dhe dëmtuar dhe nuk garantohet zhvillimi i grumbullit të ri, si dhe në sipërfaqet ose brezat pyjorë që trajtohen me pyllëzime artificiale dhe prerje rrah.

4. Pyllëzimet artificiale kryhen në tokat me bimësi pyjore, sipërfaqet e zhveshura, të gërryera dhe ranishtat, pjesë e fondit pyjor kombëtar, publik dhe privat. Për pyllëzimet artificiale, krahas llojeve autoktone, përdoren edhe lloje drurësh e shkurresh me rritje të shpejtë, të vlefshme për industrinë e përpunimit dhe për nevoja energjetike.

5. Pyllëzimet kryhen pas miratimit të projektit tekniko-ekonomik nga agjencia në përputhje me udhëzuesin teknik të miratuar nga ministri, duke përcaktuar, sipas rastit, pyllëzimin me farë ose fidanë, standardet e tyre, si dhe llojin e drurëve që do të mbillen. Projektet hartohen nga specialistët e strukturës përgjegjëse të pyjeve ose konsulentë privatë të licencuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

6. Në çdo rast, ndalohet pyllëzimi me farë në terrenet e zhveshura, nëse nga ekspertët specialistë pyjorë konsiderohet i pamundur instalimi i filizërisë me farë.

7. Për garantimin e ripërtëritjes dhe shëndetësimit të pyjeve (përfshirë parandalimin e rrezikut të shpërndarjes së sëmundjeve dhe dëmtuesve), ndalohet kryerja e aktiviteteve të mëposhtme:

a) grumbullimi, shpërndarja ose mbjellja e farave, kalemave, shpatullave e fidanëve pyjorë të drurëve e shkurreve pyjore pa lejen e agjencisë;

b) tregtimi i materialit drusor dhe i prodhimeve të tjera të pyllit, të infektuar nga sëmundjet dhe të prekura nga dëmtuesit;

c) mbjellja e farave dhe e materialit tjetër vegetativ pyjor, të pa pajisur me certifikatën përkatëse;

ç) shitja apo shpërndarja e pashoqëruar me certifikatën e origjinës dhe atë fitosanitare të materialit vegetativ mbjellës, si dhe farërave në fidanishtet që merren me aktivitetin prodhues.



KREU VII KONTROLI DHE KUNDËRVAJTJET NË SEKTORIN E PYJEVE

Neni 34

Kontrolli i veprimtarive në fondin pyjor kombëtar

1. Funksioni i kontrollit garanton ekzekutimin optimal të veprimtarive në fondin pyjor kombëtar në përputhje me dokumentet planifikuese në pyje, normat dhe standardet e miratuara, përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi, kushtet e lejeve, të licencave apo kontratave të nënshkruara mes strukturave përgjegjëse për pyjet dhe subjekteve përkatëse.

2. Kontrolli ushtrohet për veprimtaritë e shfrytëzimit dhe të shërbimeve në pyje, të cilat realizohen nga strukturat përgjegjëse për pyjet, sipas këtij ligji, dhe/ose nga subjektet përkatëse, që iu është dhënë e drejta për veprimtaritë e shfrytëzimit apo të shërbimeve në pyje, duke kontrolluar të gjithë ciklin që nga dhënia e lejeve dhe inputet e përdorura, proceset e ndjekura në kryerjen e këtyre veprimtarive, cilësinë dhe përputhshmërinë me kërkesat (konformitetin) e rezultateve të arritura, si dhe aktivitetet përmbyllëse rehabilituese sipas ligjit.

3. Funksioni i kontrollit ushtrohet nga:

- a) struktura përgjegjëse në agjenci;
- b) struktura përgjegjëse kontrolluese/inspektuese në bashki;
- c) struktura përgjegjëse në zonat e mbrojtura.

4. Funksioni i kontrollit, që ushtrohet nga strukturat sipas pikës 3 të këtij neni, realizohet përmes proceseve të inspektimit, të cilat organizohen mbi bazën e riskut të vlerësuar dhe në përputhje me metodologjitë e programet përkatëse, duke u shtrirë përgjatë të gjithë ciklit të veprimtarive në pyje, që përfshin:

a) marrjen e lejeve/licencave/kontratave/të drejtave e detyrimeve sipas ligjit, për shfrytëzimin dhe shërbimet në pyje;

b) procesin e ndjekur (respektimin e standardeve/metodologjive/udhëzuesve teknikë) dhe ekzekutimin e aktivitetëve përkatëse;

c) përfundimin dhe dorëzimin e tyre, duke kontrolluar/verifikuar aktivitetet e mbylljes dhe të rehabilitimit sipas afateve ligjore.

5. Si rezultat i proceseve të kontrollit dhe në përputhje me përcaktimet e ligjeve përkatëse për

kundërvajtjet administrative dhe për inspektimin, strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe procesin e inspektimit në pyje, nëse konstatojnë shkelje, ndërmarrin masa parandaluese dhe sanksione administrative si më poshtë:

a) këshillimin e subjekteve për përgjegjësitë e tyre, si dhe caktimin e detyrave për shmangien e parregullsive;

b) propozimin për refuzimin, pezullimin ose heqjen e lejeve dhe licencave ndaj subjekteve që ushtrojnë veprimtari në pyje, apo zgjidhjen e kontratave përkatëse nëse konstatohen shkelje të kërkesave ligjore/ kushtet dhe kriteret e certifikatës/licencës përkatëse;

c) bllokimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e prodhimeve drusore e jodrusore të siguruara në mënyrë të kundërligjshme, mjetet që kanë shërbyer për kryerjen e kundërvajtjes, si dhe çdo produkt ose përfitim pasuror të arritur përmes tyre, duke i kaluar në llogarinë e institucionit për pyjet;

ç) ndëshkimin me gjobë në përputhje me kufijtë dhe parashikimet e këtij ligji, si dhe ekzekutimin e saj;

d) vendimin për pagimin dhe rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor, si dhe ekzekutimin e tyre;

dh) kallëzimin penal sipas rastit.

Neni 35

Institucionet përgjegjëse kontrolluese

1. Agjencia, në kuadër të sigurimit të performancës në sektorin e pyjeve, si dhe vlerësimit të gjendjes së pyjeve dhe impaktit të sektorit, kryen:

a) monitorimin e treguesve kyç dhe nivelit të realizimit të politikave, programeve dhe planeve në nivel kombëtar nga strukturat përgjegjëse në bashki për pyjet;

b) mbikëqyrjen e zbatimit të akteve ligjore / nënligjore, akteve administrative, politikave, programeve dhe planeve në nivel kombëtar nga strukturat e kontrollit të pyjeve në bashki dhe në zonat e mbrojtura, si dhe ndërhyrjen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në rastet kur vëren pamundësinë ose mosushtrimin e kompetencave ligjore nga ana e tyre.

2. Strukturat përgjegjëse kontrolluese/inspektuese në bashki dhe në zonat e mbrojtura:

a) kontrollojnë përmbushjen e detyrimeve ligjore, kontraktuale, si dhe përcaktimet në planet e



mbarështimit, operacionale dhe të shfrytëzimit (përfshirë planet e rehabilitimit), nga ana e subjekteve (persona juridikë dhe fizikë), që kryejnë veprimtari në pyje;

b) parandalojnë, zbulojnë dhe marrin masa administrative në rastet e dëmtimit, të pushtimit, shpërdorimit, tjetërsimit, shkretimit dhe degradimit të pyjeve brenda territorit të tyre, si dhe bashkëpunojnë me strukturat e ngarkuara me ligj për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve;

c) parandalojnë dhe marrin masa administrative në rastet e shfrytëzimit e të tregtimit të paligjshëm të materialit drusor, të prodhimeve drusore dhe jodrusore nga pylli, të florës e faunës së egër, si dhe çdo veprimtari tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj;

ç) ndërmarrin masa administrative ndaj kundërvajtësve në pyje nëpërmjet inspektorëve pyjorë pranë strukturave përgjegjëse për kontrollin, si dhe ndjekin zbatimin e tyre deri në ekzekutimin e plotë sipas ligjit;

d) kryejnë kallëzime për shkeljet që përbëjnë vepra penale dhe ndërmarrin masa parandaluese ndaj tyre, duke ofruar ekspertizë dhe mbështetje për strukturat e mbrojtjes dhe të sigurisë së mjedisit dhe pyjeve pranë Policisë së Shtetit për verifikimin dhe hetimin e tyre;

dh) vlerësojnë dëmet e shkaktuara në pyje dhe marrin vendim zhdëmtimi në ngarkim të subjekteve kundërvajtëse për shpenzimet e dëmtimit të fondit pyjor kombëtar dhe të kthimit në gjendjen e mëparshme;

e) bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën me Policinë Bashkiake, me inspektoratet e tjera, me strukturat përgjegjëse pranë ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen dhe sigurinë e mjedisit, si dhe me institucionet apo organet e tjera, sipas rastit, për parandalimin, kontrollin dhe ndëshkimin e kundërvajtësve në fondin pyjor kombëtar;

ë) bashkëpunojnë me agjencinë dhe institucionet e tjera, sipas rastit, duke u krijuar lehtësitë e nevojshme, zbatojnë orientimet dhe detyrat e lëna, si dhe u vënë në dispozicion informacionin/dokumentacionin e kërkuar brenda një afati kalendarik 5-ditor nga data e marrjes së kërkesës.

3. Strukturat e specializuara për mbrojtjen dhe sigurinë e mjedisit dhe pyjeve, pranë ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen dhe sigurinë e mjedisit, kanë si përgjegjësi:

a) të garantojnë mbrojtjen dhe sigurinë e pyjeve përmes parandalimit, zbulimit dhe hetimit të veprave penale kundër pyjeve dhe procedimit penal të autorëve të tyre në përputhje me parashikimet e legjislacionit penal;

b) të bashkëpunojnë me strukturat përgjegjëse për kontrollin në pyje sipas këtij ligji dhe i mbështesin ato sipas kërkesës dhe nevojës.

Neni 36

Kundërvajtjet administrative në fondin pyjor kombëtar

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe, përveç vlerës së dëmit, llogaritur sipas tarifave për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor kombëtar, dënohen me gjobë sipas kufijve dhe përcaktimeve në pikat e mëposhtme në përputhje me ligjet përkatëse për kundërvajtjet administrative dhe për inspektimin.

2. Dënohen me gjobë nga 5 000 deri në 10 000 lekë shkeljet e mëposhtme:

a) nxjerrja dhe grumbullimi i prodhimeve drusore dhe jodrusore nga individë të paformalizuar dhe pa lejen përkatëse;

b) prerja pa damkë e drurëve dhe prerja pa leje e pyjeve, drurëve të veçuar dhe e shkurreve, filizërisë dhe e fidanëve në fidanishte, kur pasojat materiale janë të lehta;

c) mbledhja e prodhimeve jodrusore nga pylli jashtë periudhës teknike të vjeljes, si dhe nxjerrja e rrënjëve të drurëve pyjorë gjatë periudhës së vegetacionit;

ç) kullotja e bagëtive në fondin pyjor kombëtar të përfshirë në zonat e mbrojtura, në pyllëzimet e reja dhe në sipërfaqet me pyje të ulëta të ricunguara, në grumbujt pyjorë, që kanë arritur moshën e pjekurisë, në të cilët pritet që të arrihet ripërtëritja natyrale, në pyjet e shfrytëzuara ose në shfrytëzim e sipër deri sa të jetë bërë ripërtëritja natyrale e tyre, në pyjet e reja, në filizëri, në fidanishte, në ngastrat gjenetike e eksperimentale, në sipërfaqet ku kryhen punime përmirësuese dhe në pyjet mbrojtës;

d) krasitja për gjethe, kositja dhe grumbullimi i barit në fondin pyjor kombëtar pa lejen përkatëse;

dh) parkimi i automjeteve, vendosja e rulotëve në pyjet me funksion mbrojtës e të veçantë, në parqet kombëtare, në rezervatet e mbarështimit të



florës e të faunës së egër, në fidanishtet pyjore ose në vendet e tjera të fondit pyjor kombëtar, me rëndësi të veçantë, pa lejen përkatëse;

e) nxjerrja e gurëve, plisave, rrënjëve, cungjeve, marrja e dheut, rërës dhe zhavorrit, kur pasojat materiale janë të lehta, pa lejen përkatëse;

ë) mosruajtja e materialit drusor dhe e çdo prodhimi tjetër, me origjinë pyjore, të sekuestruar, i cili ndodhet në qendrat e përpunimit apo në sheshet e depozitimit e të tregtimit, nga subjektet të cilave u është sekuestruar, deri në shitjen e tyre.

3. Dënohen me gjobë nga 20 000 deri në 40 000 lekë shkeljet e mëposhtme:

a) ndërhyrjet për pyllëzime dhe përmirësimin e bimësisë së tokave pyjore pa lejen përkatëse dhe në kundërshtim me rregullat për pyllëzimet, përfshirë pyllëzimin me farë në terrenet e zhveshura, si dhe përdorimi i plehrave kimike apo pesticideve pa lejen përkatëse dhe në kundërshtim me rregullat;

b) grumbullimi, shpërndarja ose mbjellja e farave, kalemave, shpatullave e fidanëve pyjorë të drurëve e shkurreve pyjore pa lejen e agjencisë shtetërore përgjegjëse për pyjet, mbjellja e farave dhe e materialit tjetër vegetativ pyjor, të pa pajisur me certifikatën përkatëse, si dhe shitja apo shpërndarja nga fidanishtet, që merren me aktivitetin prodhues të materialit vegetativ mbjellës dhe farërave, të pashoqëruar me certifikatën e origjinës dhe atë fitosanitare;

c) prishja, fshirja ose dëmtimi i shenjave kufidëftuese, gjeodezike e topografike i tabelave paralajmëruese apo treguese, të vendosura në fondin pyjor kombëtar;

ç) prerja pa leje apo dëmtimi i pyjeve, në pronësi private, nga pronarët apo nga subjektet, të cilave u janë dhënë në përdorim ose me qira, kur pasojat materiale janë të lehta.

4. Dënohen me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë shkeljet e mëposhtme:

a) ngritja e strukturave, punimeve, zhvillimeve të ndryshme dhe kryerja e veprimtarive në fondin pyjor kombëtar pa lejen përkatëse;

b) ndezja e zjarreve jashtë vendeve të caktuara apo në fondin pyjor kombëtar, publik dhe privat, në tokat e tjera në afërsi të tyre, si dhe çdo veprim tjetër që përbën burim ose shkak për përhapjen e pakontrolluar të tyre;

c) prishja e shenjës së damkës në dru apo përdorimi i çekiçdamkës nga persona të paautorizuar dhe nga një zonë pyjore në tjetrën;

ç) ndryshimi i zërit kadastral në kundërshtim me procedurat ligjore në fuqi dhe mosraportimi i ndryshimeve përkatëse në fondin pyjor kombëtar dhe në tokën pyjore, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e njësisë së qeverisjes vendore dhe pronarin privat;

d) shndërrimi i pyjeve të larta në cungishte, prerja rrah e pyjeve të larta (me përjashtim të ndërhyrjeve të nevojshme për mbrojtjen fitosanitare ose për arsye të tjera me interes publik), si dhe shfrytëzimi i pyjeve cungishte dhe prerja rrah në periudhën e vegetacionit, si dhe kur nuk sigurohet mbrojtja hidrogeologjike e territorit, ruajtja e burimeve ujore, mbrojtja e peizazhit dhe mjedisit, turizmi dhe rekreacioni;

dh) prerja rrah në pyjet me funksion mbrojtës, si dhe prerjet e pyjeve në kufijtë e sipërm të vegetacionit pyjor, mbi dhe nën rrugët kombëtare deri 150 metër linear, përreth qendrave të banuara dhe objekteve të rëndësishme, përgjatë rrjedhave ujore.

5. Dënohen me gjobë nga 80 000 deri në 100 000 lekë shkeljet e mëposhtme:

a) transferimi i të drejtave të siguruara nga kontrata e trajtimit, shfrytëzimit dhe përdorimit në fondin pyjor kombëtar;

b) tregtimi i materialit drusor dhe i prodhimeve të tjera të pyllit, të infektuara nga sëmundjet, barërat e këqija e parazitare ose të prekura nga insektet;

c) mbledhja e prodhimeve jodrusore nga pylli, me mënyra që sjellin degradimin, kërcënimin, rrallimin, zhdukjen apo dobësimin e funksioneve të tyre;

ç) kryerja e veprimtarive pa lejen përkatëse kur kryhet në fondin pyjor kombëtar, të deklaruar me funksion mbrojtës e të veçantë (si ngritja e ndërtimeve të thjeshta, gardhimeve, kampingjeve, ndërhyrjet me punime në dunat bregdetare, pjesë e fondit pyjor kombëtar etj.);

d) përdorimi i paligjshëm i fondit pyjor kombëtar dhe i tokës pyjore.

6. Dënohen me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë shkeljet e mëposhtme:

a) eksporti i lëndës së drurit të papërpunuar, lëndës së ndërtimit, druve të zjarrit dhe asortimenteve që rrjedhin nga tjetërsimi i tyre, si edhe qymyrit të drurit, apo të tjera produkte, gjithmonë kur këto ndalohen specifikisht të



eksportohen me ligj apo vendim të Këshillit të Ministrave;

b) ndërtimi i objekteve dhe zhvillimi i veprimtarive, që shkaktojnë degradimin dhe gërryerjen e tokës (si: ndërtimi i furrave të gëlqeres dhe i kaminave të qymyrit të drurit, dëmtimi i infrastrukturës pyjore, si rrugë dhe vepra ujore në fondin pyjor kombëtar);

c) mosripyllëzimi i sipërfaqeve ose i brezave pyjorë pas prerjeve rrah të llojeve që nuk ripërtërihen në rrugë natyrore, si dhe mospyllëzimi/ripyllëzimi nga ana e personave fizikë/juridikë për sipërfaqe që hiqen nga fondi pyjor kombëtar;

c) hedhja e mbetjeve brenda sipërfaqes së fondit pyjor kombëtar dhe jashtë vendeve të caktuara, kur pasojat materiale janë të lehta.

7. Dënohen me gjobë nga 300 000 deri në 500 000 lekë shkeljet e mëposhtme:

a) transporti me automjete apo mjete të tjera i materialit drusor nga pylli dhe prej shesheve të depozitimit për në qendrat e përpunimit e të shitjes, si dhe i produkteve jodrusore pyjore drejt qendrave të grumbullimit, i pashoqëruar me dokumentacionin që provon origjinën e tij;

b) mosrealizimi i masave apo punimeve të parashikuara në projekte në mjedisin pyjor, si dhe mospastrimi i parcelës së shfrytëzuar.

8. Dënohen me gjobë nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë shkeljet e mëposhtme:

a) shkarkimet e kimikateve, të ujërave të ndotura industriale në fondin pyjor kombëtar;

b) gërmimi për karriera të çdo lloji që përdorin lëndë plasëse pa lejen përkatëse;

c) djegia e sipërfaqeve në fondin pyjor kombëtar, me qëllim ndryshimin e destinacionit të tyre, ndryshimin e destinacionit të sipërfaqeve të djegura në fondin pyjor kombëtar, si dhe kur cenon ruajtjen e biodiversitetit, stabilitetin e terrenit, regjimin e ujit, mbrojtjen nga rënia e gurëve dhe ortekëve, ruajtjen e peizazhit, si dhe rolin e pyjeve për mbrojtjen nga era.

9. Kur pasojat janë të rënda, për shkeljet e cituara më poshtë dënimi me gjobë është si vijon:

a) prerja pa damkë e drurëve dhe prerja pa leje e pyjeve, drurëve të veçuar dhe e shkurreve, filizërisë dhe e fidanëve në fidanishte, kur pasojat janë të rënda, dënohet me gjobë me vlerë nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë;

b) nxjerrja e gurëve, plisave, rrënjëve, cungjeve, marrja e dheut, rërës dhe zhavorrit, kur pasojat janë të rënda, pa lejen përkatëse, dënohet me gjobë me vlerë nga 100 000 deri në 300 000 lekë;

c) hedhja e mbetjeve brenda sipërfaqes së fondit pyjor kombëtar dhe jashtë vendeve të caktuara, kur pasojat janë të rënda, dënohet me gjobë me vlerë nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë.

10. Kriteret për ndarjen e shkeljeve me pasoja të lehta apo me pasoja të rënda dhe sanksionet financiare caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. Kur shkeljet e këtij ligji kanë sjellë pasoja të rënda, struktura përkatëse bën kallëzim penal.

11. Kur institucionet, strukturat apo personat përgjegjës për fondin pyjor kombëtar, me veprimet apo mosveprimet e tyre, nuk kanë zbatuar përgjegjësitë ligjore, krahas detyrimit për ushtrimin e ndjekjes së procedurave disiplinore administrative, dënohen edhe me gjobë nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë, sipas përcaktimeve në këtë ligj dhe, sipas rastit, bëhet edhe njoftimi zyrtar në organet e procedimit penal. Gjohat e parashikuara në këtë pikë vendosen nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë dhe kundër tyre mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve pranë ministrit, i cili duhet të shprehet brenda 10 ditëve. Kundër vendimit të ministrit mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

Neni 37

Përgjegjësia për dëmet në fondin pyjor kombëtar

1. Personi fizik apo juridik, veprimet ose mosveprimet e të cilit ndikojnë në ndotjen dhe/ose dëmtimin e fondit pyjor kombëtar, përveç përgjegjësiave të tjera, mban edhe përgjegjësi financiare, duke përballuar kostot e shkaktuara nga ky dëmtim apo rrezik për fondin pyjor kombëtar, mbështetur në parimin “dëmtuesi paguan”. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar në fondin pyjor kombëtar garanton:

a) parandalimin dhe zhdëmtimin e të gjithë dëmit që i shkaktohet fondit pyjor kombëtar;

b) rehabilitimin e pjesëve të dëmtuara të fondit pyjor kombëtar;

c) prezantimin e masave dhe të praktikave për minimizimin e rrezikut të dëmtimit të pyjeve.



2. Veprimtaritë që konsiderohen të rrezikshme dhe dëmtuese për fondin pyjor kombëtar, kriteret në bazë të të cilave bëhet vlerësimi i kërcënimit të mundshëm dhe përcaktimi i dëmit në fondin pyjor kombëtar, si dhe metoda për përcaktimin e kostove dhe specifikimin e shpenzimeve për eliminimin apo rehabilitimin e dëmit të shkaktuar bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

3. Masat që lidhen me rehabilitimin e pjesëve të dëmtuara të fondit pyjor kombëtar miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 38

Procedimi në fondin pyjor

1. Të drejtën e procedimit administrativ për zbatimin e këtij ligji e kanë strukturat përgjegjëse për pyjet, sipas këtij ligji, nëpërmjet inspektorëve përkatës të tyre, të cilët, kur evidentojnë shkelje:

a) mbajnë procesverbal në momentin e konstatimit të kundërvajtjes, që nënshkruhet nga hartuesi i tij, dëshmitarët, nëse ka të tillë, dhe kundërvajtësi. Procesverbali është i vlefshëm edhe vetëm me nënshkrimin e hartuesit, sipas kompetencës territoriale;

b) dokumentojnë shkeljet me të gjitha mjetet e mundshme, foto, regjistrime zanore e video;

c) ndjekin procedurat e mëtejshme për dënimin e kundërvajtësit sipas ligjit dhe detyrimin për shpërblimin e dëmit deri në ekzekutimin e tyre.

2. Inspektorët e pyjeve kanë të gjitha të drejtat për të hyrë, kontrolluar, realizuar procesin e inspektimit dhe për të marrë masat përkatëse të procedimit, si dhe të bllokimit apo të sekuestrimit në rastet e shkeljeve.

3. Masa e gjobës përcaktohet, në çdo rast, në përpjesëtim të drejtë me rëndësinë dhe natyrën e kundërvajtjes së konstatuar dhe pasojat e ardhura, me rrethanat, përgjegjësinë dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje të zyrtarit ose të kundërvajtësit dhe me faktin nëse kundërvajtësi është përsëritës apo jo.

4. Në rast përsëritjeje të kundërvajtjes, kundërvajtësi dënohet me dyfishin e vlerës së gjobës.

5. Në përputhje me rastet dhe nevojat, krahas dënimit kryesor me gjobë, merren edhe masa urgjente sipas ligjit përkatës për kundërvajtjet administrative dhe për inspektimin.

6. Për subjektet e dënuara, struktura përgjegjëse për pyjet, sipas këtij ligji, paraqet kërkesën për heqjen e licencës përkatëse dhe autoritetet përgjegjëse janë të detyruara të marrin vendim për heqjen e licencës brenda pesë ditëve. Subjekti, të cilit i është hequr licenca, nuk mund të pajiset më me të njëjtën licencë për 5 vjetët në vijim.

7. Për çdo rast kundërvajtjeje administrative apo vepre penale të kryer ndaj fondit pyjor kombëtar vlerësohet edhe dëmi real që është shkaktuar (llogaritur sipas tarifave përkatëse) dhe kërkohet zhdëmtimi i tij nga personi/subjekti përgjegjës sipas ligjit.

8. Procedura dhe vendimmarrja për dënimin dhe masat përkatëse, ankimi dhe ekzekutimi rregullohen nga legjislacioni në fuqi për kundërvajtjet administrative dhe inspektimin. Përmbajtja dhe modelet e akteve për kundërvajtjet në pyje miratohen me urdhër të ministrit.

9. Të ardhurat që vijnë nga ekzekutimi i vendimeve të dënimit dhe i masave përkatëse derdhen në fondin e pyjeve në buxhetin e institucionit përkatës, me detyrimin për t'u investuar përsëri në pyje.

KREU VIII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 39

Dispozitat e fundit

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 9385, datë 4.5.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Aktet nënligjore të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe për aq sa nuk bien ndesh me të, mbeten në fuqi dhe do të zbatohen deri në miratimin e akteve të reja nënligjore në zbatim të këtij ligji.

3. Parashikimet ligjore që lidhen me procedurën e transferimit dhe regjistrimit të pyjeve kanë fuqi ligjore deri në përfundimin e procesit të regjistrimit.

4. Për të reduktuar ndërhyrjet në fondin pyjor kombëtar, frenimin e degradimit si pasojë e mbishfrytëzimit apo dëmtime të tjera, mund të vendosen ndalime me ligj të veçantë për periudha të caktuara kohore, që gjykohen të nevojshme për përmirësimin dhe rehabilitimin e gjendjes së fondit pyjor kombëtar.



5. Dispozitat e këtij ligji, që bien në kundërshtim me ligjin nr. 5/2016 “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, nuk do të zbatohen deri në momentin që ky moratorium do të jetë në fuqi.

6. Kuadri ligjor ekzistues i fushave apo sektorëve të tjerë, që ndikon dhe ndërlidhet me fondin pyjor kombëtar, duhet të harmonizohet me përcaktimet e këtij ligji, duke përfshirë legjislacionin për zonat e mbrojtura, për bimët mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore, për gjuetinë, florën dhe faunën e egër, për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, për kadastrën shtetërore etj. Në çdo rast, rëndësia kombëtare dhe interesi publik për fondin pyjor, si pasuri kombëtare, prevalojnë mbi interesat e tjerë.

Neni 40

Dispozita kalimtare

1. Në funksion të ngritjes në rang kombëtar të një sistemi të integruar të planifikim-zhvillimit të fondit pyjor kombëtar, ngarkohet agjencia të kryejë analizën e dokumenteve ekzistuese, vlerësimin e dokumenteve të planifikimit, që janë të nevojshme për të gjithë fondin pyjor kombëtar, dhe përllogaritjen e kostove dhe afateve të nevojshme për hartimin e tyre.

2. Strukturat, organet dhe institucionet ekzistuese në sektorin e pyjeve vazhdojnë funksionimin e tyre deri në ngritjen/ riorganizimin e strukturave, të organeve dhe institucioneve të reja, sipas përcaktimeve dhe afateve të këtij ligji.

3. Ngarkohen organet e bashkive që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të përcaktojnë dhe të miratojnë ngritjen/ riorganizimin e strukturave përgjegjëse për pyjet, ku përfshihen edhe ato kontrolluese, sipas përcaktimeve në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim.

4. Agjencia, në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror, unifikon praktikat për kontrollin dhe procesin e inspektimit në fondin pyjor kombëtar nga strukturat përgjegjëse në ushtrimin e kompetencave të tyre.

5. Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në ngritjen dhe funksionimin e strukturave të reja kontrolluese/inspektuese, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj dhe në aktet nënligjore.

6. Çdo referim në ligje të tjera tek Inspektorati/Policia Pyjore dhe për shkelje në fondin pyjor kombëtar do të nënkuptojë respektivisht kontrollin dhe procesin e inspektimit sipas strukturave të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, përveç mbrojtjes dhe sigurisë së pyjeve ndaj veprave penale në to, për të cilat bëhet referim në strukturat e posaçme të mbrojtjes së pyjeve pranë ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen dhe sigurinë e mjedisit.

Neni 41

Detyrimet për nxjerrjen e akteve

1. Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për pyjet, financat, punën dhe çështjet sociale që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore përkatëse.

2. Ngarkohet ministri që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë udhëzimet në zbatim të neneve 4, pika 2; 5, pika 5; 23, pika 2, shkronja “a”; 25, pikat 3 dhe 6; 30, pika 9; 31, pika 8; 32, pika 1, shkronja “c”; dhe 37, pika 3, të këtij ligji.

3. Agjencia shtetërore përgjegjëse për pyjet, brenda 12 muajve nga fillimi i veprimtarisë së saj, realizon miratimet, harton standardet, specifikimet, rregullat, lejimet dhe ushtron detyrat e parashikuara në këtë ligj.

Neni 42

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 30.4.2020

Shpallur me dekretin nr. 11490, datë 26.5.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta



DEKRET

Nr. 11490, datë 26.5.2020

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93,
të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 336 lekë